A i bleve vajzës sate ca libra?

Po, vajzës sime i bleva ca libra.

Po unë, a i bleva simes një palë këpucë?

Po, ti i bleve sates një palë këpucë.

A e more kapelën tände me vete?

Jo, unë e mora kapelën time me vete.

A e lash unë timen në shtëpi?

Po, ti e le tänden në shtëpi.

A more letër prej hallës sate?

Po, mora letër prej hallës sime.

Po unë, a mora letër prej simes?

Po, edhe ti more letër prej sates.

b. (jona - jueja)

A është mësuesja juej nga Korça?

Po, mësuesja jonë është nga Korça.

A është jona nga Durrësi?

Po, jueja është nga Durrësi.

A është burri i mësueses suej llogaritár?

Po, burri i mësueses sonë është llogaritár.

Po burri i sonës, a është oficer?

Po, burri i suejës është oficer.

c. (të mijat - të tuat)

A shkojnë në shkollë përditë vajzat e tua?

Po, vajzat e mija shkojnë në shkollë përditë.

Po të mijat, a shkojnë përditë?

Po, edhe të tuat shkojnë përditë.

A është kjo shkolla e vajzave të tua?

Po, kjo është shkolla e vajzave të mija.

Po ajo atje, a është e të mijave?

Po, ajo atje është e të tuave.

d. (tonat - tujat)

A banojnë motrat tujat në Shkodër?

Po, motrat tona banojnë në Shkodër.

A banojnë tonat në Tiranë?

Po, tujat banojnë në Tiranë.

A është kjo shtëpi e motrave tujat?

Po, kjo shtëpi është e motrave tona.

Po ajo, a është e tonave?

Po, ajo është e tujave.

e. (e saja - e tynja)

Cila macë është e bardhë: e saja apo e tynja?

E saja është e bardhë; e tynja është e zezë.

Çfarë ngjyre ka e saja dhe çfarë ngjyre ka e tynja?

E saja është e bardhë; e tynja është e zezë.

A është kjo çantë e vajzës së saj apo e vajzës së tynës?

Kjo çantë është e vajzës së saj; ajo është e vajzës së tynës.

Cila është e së sajës dhe cila e së tynës?

Kjo është e së sajës dhe ajo është e së tynës.

f. (të sajat - të tynët)

A janë këto pënda të sajat apo të tynët?

Këto pënda janë të sajat; ato aty janë të tynët.

Cilat janë të sajat dhe cilat janë të tynët?

Këto këtu janë të sajat dhe ato aty janë të tynët.

A janë këto brusha të vajzave të saja apo të vajzave të tyre?

Këto brusha janë të vajzave të saja, ato aty janë të vajzave të tyre.

Cilat brusha janë të sajave dhe cilat janë të tyreve?

Këto këtu janë të sajave dhe ato aty janë të tyreve.

g. (e vetja - të vetat)

A është ajo shtëpi e vetja?

Po, ajo shtëpi është e vetja.

Po ato dyqane, a janë të vetat?

Po, edhe ato dyqane janë të vetat.

h. (e tija - të tija)

Goma jote është mbi tryezë; ku është e tija?

Edhe e tija është mbi tryezë.

Këto janë pëndat e mija; ku janë të tija?

Të tija janë mbi libër.

Kjo është kapela e vajzës sime; ku është kapela e së tijës?

Kapela e së tijës është në raft.

Këto janë pëndat e vajzave tona; ku janë pëndat e së tijave?

Pëndat e së tijave janë në syzë.

2.

a. A është kali një kafshë e fuqishme?

Po, kali është një kafshë e fuqishme.

Çfarë kafshe është kali?

Kali është një kafshë e fuqishme.

A është e fuqishme radioja juej?

Po, radioja ime është e fuqishme.

Radioja e kujt është e fuqishme?

Radioja ime është e fuqishme.

A janë të fuqishëm motorat e automobilave të rij?

Po, motorat e automobilave të rij janë të fuqishëm.

Cilët motora janë të fuqishëm?

Motorat e automobilave të rij janë të fuqishëm.

Motorat e cilëve automobila janë të fuqishëm?

Motorat e automobilave të rij janë të fuqishëm.

A keni ndigjue ndonji lajm të rëndësishëm?

Jo, nuk kam ndigjue ndonji lajm të rëndësishëm.  
Kush nuk ka ndigjue ndonji lajm të rëndësishëm?

Unë nuk kam ndigjue ndonji lajm të rëndësishëm.  
A shkoni ju shpesh në Korçë sepse keni punë të rëndësishme?

Po, unë shkoj shpesh në Korçë sepse kam punë të rëndësishme.

Kush shkon shpesh në Korçë sepse ka punë të rëndësishme?

Unë shkoj shpesh në Korçë sepse kam punë të rëndësishme.

A është e rrezikshme me pî duhan në krevat?

Po, është e rrezikshme me pî duhan në krevat.

Ku është e rrezikshme me pî duhan?

Asht e rrezikshme me pî duhan në krevat.

Çka është e rrezikshme me bâ në krevat?

Asht e rrezikshme me pî duhan në krevat.

A është e rrezikshme me e ngá automobilin 150 km. n'orë?

Po, është e rrezikshme me e ngá automobilin 150 km. n'orë.

Çka është e rrezikshme me e ngá 150 km. n'orë?

Asht e rrezikshme me e ngá automobilin 150 km. n'orë.

A është tenisi nji lojë e rrezikshme?

Jo, tenisi nuk është nji lojë e rrezikshme.

Cila lojë nuk është e rrezikshme?

Tenisi nuk është nji lojë e rrezikshme.

A është i shijshëm mishi i derrit?

Po, mishi i derrit është i shijshëm.

Cili mish është i shijshëm?

Mishi i derrit është i shijshëm.

Qysh është mishi i derrit?

Mishi i derrit është i shijshëm.

A janë të shijshme pjeshkat?

Po, pjeshkat janë të shijshme.

Cilat pemë janë të shijshme?

Pjeshkat janë të shijshme.

b. A është e punueshme kjo tokë?

Po, kjo tokë është e punueshme.

Cila tokë është e punueshme?

Kjo tokë është e punueshme.

A janë të punueshme të gjitha tokat në Shqipëri?  
 Jo, të gjitha tokat nuk janë të punueshme në Shqipëri.

A është i pishëm uji që është në shishe?  
 Po, uji që është në shishe është i pishëm.

Cili ujë është i pishëm?  
 Uji që është në shishe është i pishëm.

A është i pishëm uji i shiut?  
 Po, uji i shiut është i pishëm.

Cili ujë është i pishëm?  
 Uji i shiut është i pishëm.

A është i pishëm uji i detit?  
 Jo, uji i detit nuk është i pishëm.

Cili ujë nuk është i pishëm?  
 Uji i detit nuk është i pishëm.

A është e lejueshme me pî duhan në klasë?  
 Jo, nuk është e lejueshme me pî duhan në klasë.

Ku nuk është e lejueshme me pî duhan?  
 Nuk është e lejueshme me pî duhan në klasë.

A është e lejueshme me nga automobilin 130 km.  
 n'orë?

Jo, nuk është e lejueshme me nga automobilin  
 130 km. n'orë.

Çka nuk është e lejueshme me bâ?

Nuk është e lejueshme me nga automobilin 130  
 km. n'orë.

A është i lexueshëm shkrimi i mjekëve, zakonisht?  
 Jo, shkrimi i mjekëve zakonisht nuk është  
 i lexueshëm.

Shkrimi i kujt nuk është i lexueshëm, zakonisht?  
 Shkrimi i mjekëve nuk është i lexueshëm,  
 zakonisht.

c. A është kjo buka e sotshme apor e djeshme?  
 Kjo është buka e sotshme.

Cila është buka e sotshme?  
 Kjo është buka e sotshme.

Cila është buka e djeshme?  
 Ajo është buka e djeshme.

A është kjo gazeta e sotshme apor e djeshme?  
 Kjo është gazeta e djeshme.

A ka qenë e nxehët vera e sivjetshme?  
 Po, vera e sivjetshme ka qenë e nxehët.  
 Cila verë ka qenë e nxehët?  
 Vera e sivjetshme ka qenë e nxehët.  
 Si ka qenë vera e vjetshme?  
 Vera e vjetshme ka qenë e freskët.

A është kjo gazetë e përditshme?  
 Po, kjo gazetë është e përditshme.  
 Cila gazetë është e përditshme?  
 Kjo gazetë është e përditshme.  
 A është kjo revistë e përmuejshme?  
 Po, kjo revistë është e përmuejshme.  
 Cila revistë është e përmuejshme?  
 Kjo revistë është e përmuejshme.  
 Po ato revista, a janë të përmuejshme apor të përjavshme?  
 Ato revista janë të përjavshme.  
 Cilat revista janë të përjavshme.  
 Ato revista janë të përjavshme.

3.

a. A i ndigjove mbrëmë lajmet e radios?  
 Po, mbrëmë i ndigjova lajmet e radios.  
 Kur i ndigjove lajmet e radios?  
 Mbrëmë i ndigjova lajmet e radios.  
 Cilat lajme ndigjove mbrëmë?  
 Mbrëmë i ndigjova lajmet e radios.

A ka ndonji lajm në gazetë?  
 Po, në gazetë ka shumë lajme.  
 Çka ka në gazetë?  
 Në gazetë ka shumë lajme.

A përmban vetëm përralla për fëmijë ky libër?  
 Po, ky libër përmban vetëm përralla për fëmijë.  
 Çka përmban ky libër?  
 Ky libër përmban përralla për fëmijë.

A ka në Shqipni shumë lloj pemësh?  
 Po, në Shqipni ka shumë lloj pemësh.  
 Çfarë lloj pemësh ka në Shqipni?  
 Në Shqipni ka shumë lloj pemësh.  
 Sa lloj pemësh ka në Shqipni?  
 Në Shqipni ka shumë lloj pemësh.  
 Ku ka shumë lloj pemësh?  
 Në Shqipni ka shumë lloj pemësh.

A ka njerëz që thonë shumë gënjeshtër?

Po, ka njerëz që thonë shumë gënjeshtër.

A është mirë me thënë gënjeshtër?

Jo, nuk është mirë me thënë gënjeshtër.

Çka nuk është mirë me bërë?

Nuk është mirë me thënë gënjeshtër.

A ju pëlqen me bisedue punë politike?

Jo, nuk më pëlqen me bisedue punë politike.

Kujt nuk i pëlqen me bisedue punë politike?

Mue nuk më pëlqen me bisedue punë politike.

Çka nuk ju pëlqen me bërë?

Nuk më pëlqen me bisedue punë politike.

Çfarë punësh nuk ju pëlqen me bisedue?

Nuk më pëlqen me bisedue punë politike.

A ju pëlqen muzika e lehtë?

Po, mue më pëlqen muzika e lehtë.

Kujt i pëlqen muzika e lehtë?

Mue më pëlqen muzika e lehtë.

Çka ju pëlqen?

Mue më pëlqen muzika e lehtë.

Çfarë lloj muzike ju pëlqen?

Mue më pëlqen muzika e lehtë.

A ka radioja juej valë të shkurta?

Po, radioja ime ka valë të shkurta.

Radioja e kujt ka valë të shkurta?

Radioja ime ka valë të shkurta.

Çfarë valësh ka radioja juej?

Radioja ime ka valë të shkurta.

A kanë zë të fortë disa njerëz?

Po, disa njerëz kanë zë të fortë.

Kush ka zë të fortë?

Disa njerëz kanë zë të fortë.

Çfarë zëni kanë disa njerëz?

Disa njerëz kanë zë të fortë.

Ca vjet m<sup>a</sup> par<sup>e</sup>, kur banojshem n'Itali, pothuej çdo ditë e kishem zakon me ndigjue programet e Radio Tiranës me valë të mesme. Kët gj<sup>a</sup> e b<sup>a</sup>jshem jo se dojshem me marrë vesh se cilat ishin lajmet e ditës, por sepse më pëlqente me ndigjue muzikë të vendit.

Si dihet, Radio Tirana, si të gjitha radiostacionet tjera të Shqipn<sup>i</sup>, <sup>a</sup>sht e qeveris dhe lajmet e saja janë plot me gënjeshtre e propagandë. Mjerisht, këtu në SHBA ky program nuk ndigjohet, megjithëse stacioni <sup>a</sup>sht shumë i fuqishëm. Dy stacionet tjera që v<sup>i</sup>jnë mbas atij të Tiranës janë radiostacioni i Shkodrës dhe ai i Korçës.

Përparimet që kanë b<sup>a</sup> katundarët në bujqësi, prodhimet që janë marrë nga toka dhe nga kafshët, dhe informatat mbi jetën e punën e puntorëvet ndër fabrika, janë lajmet kryesore të përditshme që apin vazhdimisht radiot në Shqipn<sup>i</sup>. Radio Tirana ka edhe një stacion të dytë me valë të shkurta. Ky stacion, që ndigjohet edhe në Lindje t'Amerikës, ep lajme në gjuhë të hueja dhe një program të posaçëm që quhet "Emision i Posaçëm për Shqiptarët jashtë Atdheut." Në kët program, përveç lajmevet që thamë m<sup>a</sup> nalt,

qeverija shqiptare shán e kritikon si refugjatët politikë shqiptarë ashtu edhe shtetet e botës së lirë, sidomos SHBA.

Edhe jashtë Shqipnis epen lajme në gjuhën shqipe, si p.sh. nga Uashingtoni me anë të "Zânit t'Amerikës," nga Roma, nga Vatikani, nga Beogradi etj. Mjerisht këto lajme nuk mund t'i ndigjojnë të gjithë shqiptarët n'atdhë, sepse shumë prej tyre nuk kanë radio dhe ca tjerë nuk kanë leje nga qeverija me mbajtë radio.

---

#### QUESTIONS-PYETJE

1. Ku banojshem ca vjet më parë?
2. Çka kishem zakon me ndigjue pothuëj çdo ditë?
3. Me çfarë valësh transmetoheshim programet e Radio Tiranës që ndigjojshem unë?
4. A dojshem me marrë vesh se cilat ishin lajmet?
5. Çka më pëlqente me ndigjue?
6. Të kujt janë Radio Tirana dhe të gjitha radio-stacionet tjera të Shqipnis?
7. Plot me çka janë lajmet e qeveris së Shqipnis?
8. Cili program nuk ndigjohet këtu në SHBA?
9. Qysh është stacioni i Radio Tiranës?
10. Cilat janë dy stacionet tjera që vijnë mbas atij të Tiranës?

11. Cilat janë lajmet kryesore të përditshme që apin radiot në Shqipni?
12. A janë ca nga lajmet kryesore të përditshme prodhimet që katundarët kanë marrë nga toka e nga kafshët?
13. Po informatat mbi jetën e punën e puntorëvet ndër fabrika, a janë lajme kryesore të përditshme.
14. Me çfarë valësh transmeton Tirana në stacionin e dytë?
15. Në çë vend t'Amerikës ndigjohen lajmet me valë të shkurta nga Tirana?
16. Në çfarë gjuhe epen lajmet me valë të shkurta nga Radio Tirana?
17. Si quhet programi që ep lajme për shqiptarët jashtë atdheut?
18. Kë shán e kritikon qeverija shqiptare në këtë program?
19. Cilin shtet shán e kritikon më tepër qeverija shqiptare?
20. Edhe ku tjetër epen lajme në gjuhën shqipe?
21. Kush nuk mund t'i ndigjojë lajmet shqipe që epen jashtë Shqipnis?
22. Çka nuk kanë shumë prej shqiptarëvet n'atdhé?
23. Pse nuk kanë radio ca shqiptarë tjerë?
24. E pra, pse nuk mund t'i ndigjojnë të gjithë shqiptarët n'atdhé lajmet në gjuhën shqipe që epen nga jashtë?

PJESA E GJASHTË  
DETYRË SHTEPIJE

LESSON 56  
PART VI  
HOMEWORK

Translate:

1. Let's take this road, it's shorter than the other one.
2. I have never eaten this kind of food in my life.
3. I don't have any news for you; I am sorry.
4. He likes music very much, especially modern music.
5. He is somewhat better; that's what his doctor told me.

Përkëtheni anglisht:

6. Dha vetëm lajmet e ditës e nuk bëni asnjë koment.
7. Një ndër njerzit më të fuqishëm në Shqipëri është Ministri i Punëve të Brendshme.
8. "Zani i Amerikës" transmeton lajme e komente tri herë në ditë; me valë të shkurta natyrisht, sepse Shqipëria është një 4000 mila larg nga Amerika.
9. Nuk e di se ç'përbante letra, sepse nuk e pashë.
10. Foli në radio, por s'tha tjetër veçse gënjeshtër.

PJESA E SHTATË  
FJALORI

LESSON 56  
PART VII  
VOCABULARY

atdhé, -u	(m.)	fatherland, country
botë, -a	(f.)	world
diçka	(pron. & adv.)	something; somewhat
emision, -i emisione, -t	(m.)	(radio) broadcast; emission
folës, -i folës, -it	(m.)	speaker
i, të fuqishëm e, të fuqishme	(adj. m. & f.)	powerful, strong, mighty
gënjeshtër, gënjeshtër gënjeshtër, -t	(f.)	lie
juguer, jugore	(adj. m. & f.)	south, southern
kilovat, -i kilovatë, -t	(m.)	kilowatt
koment, -i komente, -t	(m.)	comment
me kritikue (unë kritikoj)	(v.)	to criticize
lajm, -i lajme, -t	(m.)	news
muzikë, -a	(f.)	music
me përmbajtë (unë përmbaj)	(v.)	to contain; refrain
përparim, -i përparime, -t	(m.)	progress, advance, advancement
politik, -ë politike	(adj. m. & f.)	political

LESSON 56

i, të posaçëm e, të posaçme	(adj. m. & f.)	special, particular
program, -i programe, -t	(m.)	program
propagandë, -a propaganda, -t	(f.)	propaganda
radio, -ja radio, -t	(f.)	radio
radiostacion, -i radiostacione, -t	(m.)	radio station
refugjat, -i refugjatë, -t	(m.)	refugee
me shá (unë sháj)	(v.)	to call names, to insult
i, e, të shkurtë të shkurta	(adj. m. & f.)	short
transmetim, -i transmetime, -t	(m.)	broadcast, transmission
me transmetue (unë transmetoj)	(v.)	to broadcast, to transmit
me u-transmetue (transmetohet)	(v.)	to be broadcast, transmitted
valë, -a valë, -t	(f.)	wave
veçanërisht	(adv.)	especially, particularly
za, -ni zane, -t	(m.)	voice, sound
<u>Shenime:</u> s'ka përse		you are welcome (a response to thank you)

PJESA E PARË  
USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE-GRAMMAR PERCEPTION DRILL

LESSON 57  
PART I

- 1.
- a. A ju thom unë me i mbyllë librat?  
Po, ju na thoni me i mbyllë librat.
- A i mbani ju librat të mbyllun?  
Po, na i mbajmë librat të mbyllun.
- A është ky libri juej?  
Po, ai është libri im.
- A është i mbyllun libri juej?  
Po, libri im është i mbyllun.
- A ju pëlqen me i mbajtë librat mirë?  
Po, më pëlqen me i mbajtë librat mirë.
- A është ky libër i mbajtur mirë?  
Po, ky libër është i mbajtur mirë.
- b. A e ka përdorë ai automobilin?  
Po, ai e ka përdorë automobilin.
- A është i përdorun automobili i tij?  
Po, automobili i tij është i përdorun.
- Automobili i kujt është i përdorun?  
Automobili i tij është i përdorun.
- Qysh është automobili i tij?  
Automobili i tij është i përdorun.
- A janë të përdorun automobilat e tyre?  
Po, automobilat e tyre janë të përdorun.
- Automobilat e kujt janë të përdorun?  
Automobilat e tyre janë të përdorun.
- Qysh janë automobilat e tyre?  
Automobilat e tyre janë të përdorun.
- A e ka prishë ai automobilin?  
Po, ai e ka prishë automobilin.

A është i prishun automobili i tij?  
Po, automobili i tij është i prishun.

Automobili i kujt është i prishun?  
Automobili i tij është i prishun.

Qysh është automobili i tij?  
Automobili i tij është i prishun.

A e keni grisë ju këtë gazetë?  
Po, unë e kam grisë këtë gazetë.

A është e grisun kjo gazetë?  
Po, kjo gazetë është e grisun.

Cila gazetë është e grisun?  
Kjo gazetë këtu është e grisun.

c. A e ka lã ai automobilin?  
Po, ai e ka lã automobilin.

A është i lamë automobili i tij?  
Po, automobili i tij është i lamë.

Automobili i kujt është i lamë?  
Automobili i tij është i lamë.

Qysh është automobili i tij?  
Automobili i tij është i lamë.

A janë të lamë automobilat e tyre?  
Po, automobilat e tyre janë të lamë.

Automobilat e kujt janë të lamë?  
Automobilat e tyre janë të lamë.

Qysh janë automobilat e tyre?  
Automobilat e tyre janë të lamë.

A është e lame kjo pjatë?  
Po, kjo pjatë është e lame.

Cila pjatë është e lame?  
Kjo pjatë është e lame.

LESSON 57

A janë të lame këto pjata?  
Po, këto pjata janë të lame.

Cilat pjata janë të lame?  
Këto pjata janë të lame.

d. A është fejuë vllai juej?  
Po, vllai im është fejuë.

A është i fejuem vllai juej?  
Po vllai im është i fejuem.

A janë të fejuem vllaznit tuej?  
Po, vllaznit e mij janë të fejuem.

A është e fejueme motra juej?  
Po, motra ime është e fejueme.

A janë të fejueme motrat tueja?  
Po, motrat e mija janë të fejueme.

A është martue shoku juej?  
Po, shoku im është martue.

A është i martuem shoku juej?  
Po, shoku im është i martuem.

A janë të martuem shokët tuej?  
Po, shokët e mij janë të martuem.

A janë të martueme motrat tueja?  
Po, motrat e mija janë të martueme.

e. Drills with construction changes:  
(from infinitive to adjective)

me u-mërzitë - Unë jam i mërzitun.

me u-lodhë - Unë jam i lodhun.

me u-zemrue - Unë jam i zemruem.

me u-shtruar në spital - Unë jam i shtruar në spital.

me u-ftuar për darkë. - Unë jam i ftuar për darkë.

Drill other persons: ai, ajo, na, etj.

2.

a. From infinitive to verbal noun:

me mbyllë

A është detyra e kujdestarit të klasës të mbyllurit e dritorevet?

Po, të mbyllurit e dritorevet është detyra e kujdestarit të klasës.

Detyra e kujt është të mbyllurit e dritorevet?

Të mbyllurit e dritorevet është detyra e kujdestarit të klasës.

me pë

A është i ndaluem të pimit e duhanit në klasë?

Po, të pimit e duhanit në klasë është i ndaluem.

Ku është i ndaluem të pimit e duhanit?

Të pimit e duhanit është i ndaluem në klasë.

me përsëritë

A fillon t'ëjten n'orën 2 të përsëriturit e mësimevet?

Po, t'ëjten n'orën 2 fillon të përsëriturit e mësimevet.

Çka fillon t'ëjten n'orën 2?

Të përsëriturit e mësimevet fillon t'ëjten n'orën 2.

me luejtë kumár

A është zakon i keq të luejturit kumár?

Po, të luejturit kumár është zakon i keq.


Çka është zakon i keq?

Të luejturit kumár është zakon i keq.

Besë e burrëni

1. Z. Vogli, më falni një minut!
2. Urdhënoni!
3. Jam tue lexue një libër mbi Shqipërinë.
4. Anglisht?
5. Po. Në këtë libër takoj shpesh dy fjalë që nuk i kuptoj.
6. Cilat janë këto dy fjalë?
7. Njëna është fjala "besë" dhe tjetra "burrëni."  
Çka duen me thënë?
8. Asht pak e vështirë me i përkëthye.
9. A ka mundësi me më tregue ç'kuptim kanë?
10. Besa dhe burrënia janë dy veti që i dallojnë shqiptarët nga popujt tjerë të Ballkanit.
11. Çka është besa?
12. Besa është fjala e dhënun dhe siguria se kjo fjalë do të mbahet.
13. Çka ngjajnë në qoftë se besa nuk mbahet?
14. Asht turp i madh. Shqiptarët e Veriut e respektojnë edhe më fort.
15. Pse vallë ata të Veriut?
16. Sepse në kohën e Turqisë ata nuk kanë pasë autoritet qeveritar dhe kështu, për të pasë një lloj paqe e sigurije....
17. E kuptoj. Besa ishte e domosdoshme.
18. Tamam. Dhe kur stërgjyshët tonë epshin besën ata vdisshin, por nuk e thyejshin.
19. Po fjala burrëni, çka do me thënë?
20. Kur të lexoni tregimin që kemi në mësimin e sotshëm do t'a kuptoni.
21. Shumë mirë. Ju falem nderit.
22. S'ka përse.

# LESSON 57



Besë and Burrëni

1. Excuse me a minute, Mr. Vogli.
2. Please.
3. I am reading a book on Albania.
4. English?
5. Yes. In this book I often encounter two words that I do not understand.
6. Which are these two words?
7. One is the word besë and the other one is burrëni.
8. It is a little difficult to translate them.
9. Is it possible to tell me what they mean?
10. Besë and burrëni are two qualities that distinguish Albanians from other Balkan people.
11. What is besë?
12. Besë is the "given word" and the pledge that this word will be kept.
13. What happens if besë is not kept?
14. It is a disgrace; for the Northern Albanians more than for anyone else.
15. Why the Northern Albanians?
16. Because during the Turkish domination they did not have any government authorities and in order to have some peace and security ...
17. I understand (it). Besë was indispensable.
18. Right. When our forefathers gave the besë, they would rather die than break it.
19. And the word burrëni, what does it mean?
20. When you read the narrative in today's reading prose you will understand it.
21. Fine. Thank you.
22. Don't mention it.

VERBAL ADJECTIVES

In Albanian, an adjective can be formed with the past participle of a verb (the past participle is obtained by dropping me of the infinitive). In this case, the past participle is preceded by the connecting particle (i, e, të) and has one of the following suffixes: -m, -më, un.

a. Adjectives derived from verbs ending in the infinitive in -ue, -ie and -ye are formed by adding the suffixes -m (for masculine) and -me (for feminine) to the past participle of these verbs.

<u>Infinitive</u>	<u>Past participle</u>	<u>Adjective</u>
me shkruë	shkrue	(m.) i, të shkruem (f.) e, të shkrueme
me krye	krye	(m.) i, të kryem (f.) e, të kryeme
me ndie	ndie	(m.) i, të ndiem (f.) e, të ndie e

b. If the verb ends in the infinitive mood with a long vowel--nasal or otherwise--the adjective is formed by adding the suffixes -më (for masculine) and -me (for feminine) to the past participle. Examples:

<u>Infinitive</u>	<u>Past participle</u>	<u>Adjective</u>
me bā	bā	(m.) i, të bāmë (f.) e, të bāme
me vŭ	vŭ	(m.) i, të vŭmë (f.) e, të vŭme
me lā	lā	(m.) i, të lamë (f.) e, të lame

c. If the verb ends in the infinitive mood with a consonant followed by -ë, the adjective is formed by dropping -ë from the past participle and adding the suffixes -un for masculine singular and plural, and feminine singular; -una for feminine plural.  
Examples:

<u>Infinitive</u>	<u>Past participle</u>	<u>Adjective</u>
me matë	matë	(m.) i, e, të matun (f.pl.) të matuna
me hapë	hapë	(m.) i, e, të hapun (f.pl.) të hapuna
me dalë	dalë	(m.) i, e, të dalun (f.pl.) të daluna
me pasë	pasë	(m.) i, e, të pasun (f.pl.) të pasuna

#### VERBAL NOUNS

Verbal nouns are derived from verbal adjectives. The indefinite form of these nouns is rarely used. Both the indefinite and definite forms of these nouns are preceded by the connecting particle të. The definite form, which is the one that interests us, is formed by adding the suffix -it to the indefinite form. In cases where the verbal adjective ends in -ë is dropped prior to adding the suffix for the noun formation.

This type of verbal noun, which expresses an abstract idea, corresponds to the English verbal nouns ending in -ing. Examples:

Të lexuemit me zë të naltë të lodh.  
(Reading aloud is tiresome.)

Të menduemit është një proces psikik.  
(Thinking is a psychic process.)

Të pimit e duhanit është i ndaluem.  
(Smoking is forbidden.)

## LESSON 57

Plasja e nji bombe më ka damtue të ndiemit.  
(The explosion of a bomb has impaired my hearing.)

**Remark:** This type of verbal noun, which expresses an abstract idea, is treated as a neuter noun. Consequently we should remember:

1. The noun doesn't take endings through its declension.
2. When the noun, in the definite form, is followed by a genitive the particle is e.

Examples:

Të përsëritunit e mësimet është i nevojshëm.

Të pimit e duhanit është i ndaluem.



Nji nga luftat e Skënderbeut kundër turqvet  
mbas besës që lidhën shqiptarët në Lezhë 1444.

1. A është i shkruem emni i tij në listë?  
Po, emni i tij është i shkruem në listë.  
Emni i kujt është i shkruem në listë?  
Emni i tij është i shkruem në listë.  
Ku është i shkruem emni i tij?  
Emni i tij është i shkruem në listë.  
Po emni juej, a është i shkruem në listë?  
Po, edhe emni im është i shkruem në listë.  
Emni i kujt është i shkruem në listë?  
Emni im është i shkruem në listë.  
Ku është i shkruem emni juej?  
Emni im është i shkruem në listë.  
  
A i keni të shkruem ndër karta verbat?  
Po, unë i kam të shkruem ndër karta verbat?  
Kush i ka të shkruem ndër karta verbat?  
Ju i keni të shkruem ndër karta verbat?  
Kush tjetër i ka të shkruem ndër karta verbat?  
Edhe ai i ka të shkruem ndër karta verbat.  
  
A është e shkrueme letra me laps a me pëndë?  
Letra është e shkrueme me pëndë e jo me laps.  
Çka është e shkrueme me pëndë e jo me laps?  
Letra është e shkrueme me pëndë e jo me laps.  
Me çka është e shkrueme letra?  
Letra është e shkrueme me pëndë.  
  
A janë të shkrueme në fjaluer të gjitha fjalët e mësimit të sotshëm?  
Po, të gjitha fjalët e mësimit të sotshëm janë të shkrueme në fjaluer.  
Të gjitha fjalët e cilit mësimit janë të shkrueme në fjaluer?  
Të gjitha fjalët e mësimit të sotshëm janë të shkrueme në fjaluer.  
Ku janë të shkrueme të gjitha fjalët e mësimit të sotshëm?  
Të gjitha fjalët e mësimit të sotshëm janë të shkrueme në fjaluer.
2. A është i lamë filxhani im?  
Po, filxhani juej është i lamë.  
Filxhani i kujt është i lamë?  
Filxhani juej është i lamë.

Po filxhani juej, a është i lamë?  
 Po, edhe filxhani im është i lamë.  
 Cili filxhan është i lamë?  
 Filxhani im është i lamë.

A janë të lamë filxhanat tonë?  
 Po, filxhanat tonë janë të lamë.  
 Cilët filxhana janë të lamë?  
 Filxhanat tonë janë të lamë.

A është e lame tryeza e bukës?  
 Po, tryeza e bukës është e lame.  
 Cila tryezë është e lame?  
 Tryeza e bukës është e lame.

A janë të lame pjatat e supës?  
 Po, pjatat e supës janë të lame.  
 Cilat pjata janë të lame?  
 Pjatat e supës janë të lame.

3. A është i bëmë këtu n'Amerikë ky automobil?  
 Po, ky automobil është i bëmë n'Amerikë.  
 Cili automobil është i bëmë n'Amerikë?  
 Ky automobil është i bëmë këtu n'Amerikë.  
 Ku është i bëmë ky automobil?  
 Ky automobil është i bëmë këtu n'Amerikë.

A janë të bëmë në Tiranë këta çibukë?  
 Po, këta çibukë janë të bëmë në Tiranë.  
 Ku janë të bëmë këta çibukë?  
 Këta çibukë janë të bëmë në Tiranë.

A është e bëmë kjo radio n'Amerikë?  
 Jo, kjo radio është e bëmë në Japoni.  
 Ku është e bëmë kjo radio?  
 Kjo radio është e bëmë në Japoni.

A janë të bëmë në fabrikë këto mobilje?  
 Po, këto mobilje janë të bëmë në fabrikë.  
 Cilat mobilje janë të bëmë në fabrikë?  
 Këto mobilje janë të bëmë në fabrikë.  
 Ku janë të bëmë këto mobilje?  
 Këto mobilje janë të bëmë në fabrikë.

4. A jeni i mërzitun nga shiu?  
 Po, unë jam i mërzitun nga shiu.

Kush është i mërzhitun nga shiu?

Ju jeni i mërzhitun nga shiu.

Pse është i mërzhitun ai?

Edhe ai është i mërzhitun nga shiu.

A jemi të mërzhitun na nga koha e keqe?

Po, na jemi të mërzhitun nga koha e keqe.

Cilët janë të mërzhitun nga koha e keqe?

Ju jeni të mërzhitun nga koha e keqe.

Po ata, a janë të mërzhitun nga koha e keqe?

Po, edhe ata janë të mërzhitun nga koha e keqe.

A jeni të mërzhitun ju nga kjo gjellë?

Po, na jemi të mërzhitun nga kjo gjellë.

Cilët janë të mërzhitun nga kjo gjellë?

Ju jeni të mërzhitun nga kjo gjellë.

Po ata, a janë të mërzhitun nga kjo gjellë?

Po, edhe ata janë të mërzhitun nga kjo gjellë.

A është e mërzhitun ajo nga koha e keqe?

Po, ajo është e mërzhitun nga koha e keqe.

Cila është e mërzhitun nga koha e keqe?

Ajo është e mërzhitun nga koha e keqe.

Pse është e mërzhitun ajo?

Ajo është e mërzhitun nga koha e keqe.

A janë të mërzhituna ato sepse janë pa punë?

Po ato janë mërzhituna sepse janë pa punë.

Cilat janë të mërzhituna sepse janë pa punë?

Ato janë të mërzhituna sepse janë pa punë.

Pse janë të mërzhituna ato?

Ato janë të mërzhituna sepse janë pa punë.

5. A kushton 10 lekë të pastruemit e një palë rrobeve në Shqipëri?

Po, të pastruemit e një palë rrobeve në Shqipëri kushton 10 lekë.

Sa kushton të pastruemit e një palë rrobeve në Shqipëri?

Të pastruemit e një palë rrobeve në Shqipëri kushton 10 lekë.

Ku kushton të pastruemit e një palë rrobeve 10 lekë?

Në Shqipëri të pastruemit e një palë rrobeve kushton 10 lekë.

6. A kushton 2,50 lekë të lamit e një këmishë?  
 Po, të lamit e një këmishë kushton 2,50 lekë.  
 Sa kushton të lamit e një këmishë?  
 Të lamit e një këmishë kushton 2,50 lekë.  
 Çka kushton 2,50 lekë?  
 Të lamit e një këmishë kushton 2,50 lekë.
7. A është t'ëjten të përsëritunit e mësimet  
 53, 54 e 55?  
 Po, t'ëjten është të përsëritunit e mësimet  
 53, 54 e 55?  
 Kur është të përsëritunit e mësimet 53, 54 e 55?  
 T'ëjten është të përsëritunit e mësimet 53,  
 54 e 55.  
 Të përsëritunit e cilave mësim është t'ëjten?  
 T'ëjten është të përsëritunit e mësimet 53,  
 54 e 55.
8. A e përkëthyet pjesën e gazetës që ka lajme?  
 Po, e përkëtheva pjesën e gazetës që ka lajme.  
 Kush e përkëtheu pjesën e gazetës që ka lajme?  
 Ju e përkëthyet pjesën e gazetës që ka lajme.  
 Kush tjetër e përkëtheu pjesën e gazetës që  
 ka lajme?  
 Edhe ai e përkëtheu pjesën e gazetës që ka lajme.
- A i përkëthem na anglisht lajmet e radio Tiranës?  
 Po, na i përkëthem anglisht lajmet e radio  
 Tiranës.  
 Cilët i përkëthyen anglisht lajmet e radio Tiranës?  
 Ju i përkëthyet anglisht lajmet e radio Tiranës.  
 Lajmet e cilës radio përkëthyen ata anglisht?  
 Ata i përkëthyen anglisht lajmet e radio Tiranës.
9. A ju merr gjumi menjherë kur bini me fjetë?  
 Po, më merr gjumi menjherë kur bij me fjetë.  
 Po atë, a e merr gjumi menjherë kur bje me fjetë?  
 Po, edhe atë e merr gjumi menjherë kur bje  
 me fjetë.  
 Kë merr gjumi menjherë kur bje me fjetë?  
 Jú ju merr gjumi menjherë kur bini me fjetë.
10. A i keni dhënë besën atij se nuk do t'i a kallxoni  
 kurrkujt lajmin që ju dha?  
 Po, unë i a kam dhënë besën atij se nuk do t'i  
 a kallxoj kurrkujt lajmin që më dha.

LESSON 57

Kush i a ka dhënë besën atij se nuk do t'i a kallxojë kurrkujt lajmin që i dha?

Ju i a keni dhënë besën atij se nuk do t'i a kallxonit kurrkujt lajmin që ju dha.

Për çka i kam dhënë besën atij?

Ju i keni dhënë besën atij se nuk do t'i a kallxonit kurrkujt lajmin që ju dha.

11. A është Drini lumi më i gjatë i Shqipërisë?

Po, Drini është lumi më i gjatë i Shqipërisë.

Cili është lumi më i gjatë i Shqipërisë?

Drini është lumi më i gjatë i Shqipërisë.

12. A është e domosdoshme në Shqipëri me pasë leje për të shkue nga një qytet në një tjetër?

Po, për të shkue nga një qytet në një tjetër në Shqipëri është e domosdoshme me pasë leje.

Ku është e domosdoshme me pasë leje për të shkue nga një qytet në një tjetër?

Në Shqipëri është e domosdoshme me pasë leje për të shkue nga një qytet në një tjetër.

13. A keni shpëtue ju nga shumë rreziqe gjatë luftës së fundit?

Po, unë kam shpëtue nga shumë rreziqe gjatë luftës së fundit.

Kush ka shpëtue nga shumë rreziqe gjatë luftës së fundit?

Ju keni shpëtue nga shumë rreziqe gjatë luftës së fundit.

Po ai, a ka shpëtue nga shumë rreziqe gjatë luftës së fundit?

Po, edhe ai ka shpëtue nga shumë rreziqe gjatë luftës së fundit.

Gjatë cilës luftë kemi shpëtue na nga shumë rreziqe?

Na kemi shpëtue nga shumë rreziqe gjatë luftës së fundit.

14. A ka paqë e siguri në të gjitha vendet e botës?

Jo, në disa vende të botës nuk ka as paqë e as siguri.

Ku s'ka as paqë e as siguri?

Në disa vende të botës nuk ka as paqë e as siguri.

Çka s'ka në disa vende të botës?

Në disa vende të botës nuk ka as paqë e as siguri.

Unaza e kushtueshme

Nji babë, tue e ndí veten të lodhun nga mosha, mendoi që para se të vdiste t'u a ndante pasunín tre djemve të vet. Mbasi i dha secilit pjesën që i takonte, i mbeti nji unazë shumë e kushtueshme.

"Kët unazë" u tha të bijvet, "do t'i a ap atij që mbrenda tre muejve të ketë bâ nji burrëni të madhe."

Djelmt u-larguen, secili në drejtim të ndryshëm, për të gjetë rast ku mund t'a bâjshin kët burrëni që u kërkonte baba.

Mbas tre muejsh u-këthyen. I pari i tregoi t'et se nji njeri i pasun i kishte lânë amanet nji arkë plot me florij. I kishte dhânë besën se do t'i a ruente si sýt e ballit. "Kishem mundë mos me i a dhânë mâ at arkë" vazhdoi ai, "por kur ky njeri m'a kërkoi i a këtheva pa prekë asgjâ."

"Punë të mirë ke bâ, por asgjâ mâ shumë se ç'duhet të bâjmë të gjithë. Të qenët i ndershëm dhe të mbajtunit e besës nuk janë vepra të mëdhaja burrënije " i u-përgjegj i ati.

I dyti tregoi se ishte zhytë në lum, pa marrë

parasÿsh rrezikun në të cilin vÿhesh jeta e vet,  
për të shpÿtue një fëmijë të vogël që kishte rá  
mbrendë.

Edhe kÿtij i tha i ati se kishte bâ detyrën e  
asgjâ tjetër.

I treti tregoi se një ditë kishte dalë për gjah  
dhe kishte pá një njeri, të cilin e kishte marrë gjumi  
në buzë të një mali. "Pak po të kishte luejtë,"  
vazhdoi ai, "do të kishte rá poshtë e do të kishte  
vdekë. I u-afrova dhe kê me pá! Ishte anmiku im i  
rrezikshëm. Ti e di, babë, se na duem me e vrá  
njâni-tjetrin. Tue mendue se në gjumë dhe në rrezik  
nuk âsht burrëni me e vrá as anmikun, e zgjova dhe  
e largova nga ai rrezik."

"Të lumtë! Kÿsaj i thonë burrëni. Qe unazën!"  
i tha i ati.

## QUESTIONS-PYETJE

1. Kush e ndiente veten të lodhun nga mosha?
2. Çka mendoi baba para se të vdiste?
3. Kur mendoi baba t'u a ndante pasunin tre djelmve të vet?
4. Çka i dha secilit?
5. Kujt i mbeti një unazë e kushtueshme, mbasi i dha secilit pjesën që i takonte?
6. Kujt do t'i a epte baba at unazë?
7. Kur do t'i a epte baba unazën e kushtueshme njënit djalë?
8. Pse u-larguen djelmt në drejtime të ndryshme?
9. Mbas sa muejsh u-këthyen djelmt?
10. Çka tha i pari se i kishte lënë amanet një njeri i pasun?
11. Kujt i a kishte dhënë besën djali i parë se do t'i a ruente arkën me florinj?
12. Qysh do t'i a ruente arkën me florinj njeriut të pasun?
13. Kur i a këtheu ai arkën të pasunit?
14. Cili nuk kishte prekë asgjë n'arkën me florinj?
15. Kujt i tha i ati se kishte bërë punë të mirë, por asgjë më shumë se ç'duhet të bëjmë të gjithë?
16. A janë vepra të mëdhaja burrënije të qenët i ndershëm dhe të mbajtunit e besës?
17. Ku ishte zhytë i dyti?
18. Pse ishte zhytë ai në lum?

LESSON 57

19. Çka nuk kishte marrë parasÿsh i dyti kur ishte zhytë në lum?
20. Simbas t'et, çka kishte bâ edhe i dyti?
21. Për çka kishte dalë nji ditë i treti?
22. Ku e kishte marrë gjumi at njeri që pá ai?
23. Çka do t'i kishte ndodhë atij njeriu po të kishte luejtë pak?
24. Kur e njofti djali i tretë njerin që po flënte në buzë të malit?
25. Kush ishte ai njeri që po flënte në buzë të malit?
26. Çka dojshin me i bâ njâni tjetrit ata?
27. Cili mendoi se në gjumë dhe në rrezik nuk âsht burrëni me e vrá anmikun?
28. Pse e zgjoi, pra, anmikun e tij djali i tretë?
29. Kë largoi nga rreziku djali i vogël?
30. Kujt i tha i ati: "Të lumtë! Kësaj i thonë burrëni!"
31. Çka i dha i ati mâ në fund djalit të tretë?
32. Cili prej djelmvet e fitoi unazën?
33. Për çka e fitoi unazën djali i tretë?
34. Cila ishte burrënija e madhe që bâni djali i tretë?

PJESA E GJASHTË  
DËTYRË SHËTIPIJE

LESSON 57  
PART VI  
HOMEWORK

Përkëtheni anglisht:

1. Asht detyra ime të ju thom këto gjâna:
2. Shumë njerëz i merr gjumi në karrigë.
3. Kam marrë parasÿsh edhe moshën e saj.
4. Ç'kuptim kanë shqip këto fjalë?
5. Bleva një arkë qershi por një pjesë e tyre u-pri-shën sepse i lash jashtë në kopsht.
6. Në bibliotekë ndalohet të folunit me zâ të naltë.

Translate:

7. If he wants he can go on foot.
8. They could not rescue him.
9. We went for a walk (stroll) down the river.
10. I wanted to ask him if he was acquainted with Mr. Lasko.
11. Hurry! Let's leave before they come.
12. Tell me once again what happened.

PJESA E SHTATË  
FJALORI

LESSON 57  
PART VII  
VOCABULARY

me u-afrue (unë afrohem)	(v.)	to get close, to approach, to go near
amanet, -i amanete, -t	(m.)	trust, custody, keeping, safeguarding, safekeeping
anmik, -u anmiq, -t	(m.)	enemy, foe
autoritet, -i autoritete, -t	(m.)	authority
ballë, balli	(m.)	forehead, brow, front
Ballkan, -i	(m.)	the Balkans
besë, -a	(f.)	word of honor, pledge
burrëni, -ja	(f.)	character, decency; manliness; good deed
buzë, -a buzë, -t	(f.)	lip; edge, brink
me dallue (unë dalloj)	(v.)	to distinguish, to discern
i, të domosdoshëm e, të domosdoshme	(adj. m.&f.)	essential, indispensable
i, e, të dhânum të dhânuna	(adj. m.&f.)	given
flori, -ni florij, -t	(m.) (m. 1.)	gold, gold coins (pl. only)
fort	(adv.)	very, very much
kuptim, -i kuptime, -t	(m.)	meaning, sense, understanding
i, të kushtueshëm e, të kushtueshme	(adj. m.&f.)	expensive, costly
me largue (unë largoj)	(v.)	to move away, to remove, to send off

LESSON 57

lum, -i lumej, -t	(m.)	river
të lumtë	(interj.)	good for you; bravo
me marrë gjumi (mue më merr gjumi)	(v.)	to fall asleep
me marrë parasÿsh (unë marr parasÿsh)	(v.)	to consider, to take into consideration, to take into account
me u-mbajtë (unë mbahem)	(v.)	to be kept, to be held, to be con- sidered, to be sup- ported, to be main- tained, to be re- tained, to be sus- tained
të mbajtur të mbajtunit	(neut.)	keeping, holding, supporting (as nouns)
me ndá (unë ndaj)	(v.)	to divide, to sepa- rate, to share, to distribute, to split
paqë, -a	(f.)	peace
me përkëthye (unë përkëthej)	(v.)	to translate
poshtë	(adv.)	down, downstairs
me prekë (unë prek)	(v.)	to touch
të qenët	(neut.)	being (as noun)
qeveritar, -e qeveritarë	(adj.)	government, govern- mental
me respektue (unë respektoj)	(v.)	to respect; to ob- serve the working hours (the schedule)

LESSON 57

secili, secila	(adj.& pron. m.&f.)	each, each one, every, every one
me shpëtue (unë shpëtoj)	(v.)	to rescue, to survive; to save, to escape (from danger), to slip
siguri, -ja	(f.)	certainty, assurance, safety
stërgjysh, -i stërgjyshë, -t	(m.)	ancestors, forefathers, great-grandfather
tregim, -i tregime, -t	(m.)	narration
turp, -i turpe, -t	(m.)	shame, disgrace, dishonor
Turqi, -ja	(f.)	Turkey
unazë, -a unaza, -t	(f.)	ring
vepër, vepra vepra, -t	(f.)	act, action, deed, work
veti, -ja veti, -t	(f.)	characteristic, character, quality, nature, essence, individuality
me u-zhytë (unë zhytem)	(v.)	to dive, to immerse, to plunge

---

Shenime:

kësaj i thonë

this is what I (they) call

## Cultural Note:

The word besa defies easy translation into any other language. It characterizes the Albanian people. Some of the word's connotations are: the given word; the pledge; the word of honor; faithfulness, and so on. For centuries besa symbolized cohesion among the Albanians against their enemies. The Albanian swears për besë and, with a handshake, the deal is sealed, be it to fight for a cause, for the fatherland, to keep a secret, etc., and only death can free one from this kind of pledge.

This word is used by the Albanians' neighbors to describe one of the peculiar qualities of the Albanians. The man who breaks besa is disgraced for life and even the members of the family do not accept him as an equal.

Jam në besë tande, "I am at your mercy," is a saying that saves one from any kind of mischief committed. The man to whom this plea is directed is obliged to protect the person, even if he is the murderer of one of the members of the family. Often times, the father has protected the murderer of his own son.

This trust in the given word, this unique sort of pledge has conflicted with the administration of law and order in Albania in modern times.

---

Nji i sëmundë, që ishte shtrur në spital nga pika në zemër, fitoi një milion dollarë në lotari. Pjesëtarët e familjes nuk ia kallxuen këtë gjë të sëmundit nga frika se atij mund t'i tronditej zemra dhe mund të vdiste; megjithatë ata biseduan me mjekun, i cili mori përsipër ta lajmonte të sëmundin për fitimin e lotaris. Mjeku, nga ana e tij, e siguroi familjen se çdo gjë do të shkonte mirë, dhe kështu shkoi te i sëmundi dhe filloi me bisedue me të gjëna të ndryshme. Më në fund e pruni fjalën ke lotarija dhe e pyeti të sëmundin:

"Çka do të bëjshë po të fitojshë një milion dollarë në lotari?"

"Gjymshën e të hollavet do të ju a epshem jû, Zotni doktor," i u-përgjegj i sëmundi.

N'at moment doktorit i rá pika në zemër edhe vdiq nga gëzimi i papritun.

PJESA E PARË  
 USHTRIMË GRAMATIKORE PARAPRAKE-GRAMMAR PERCEPTION DRILL

- 1.
- a. Në qoftë se shkoni ju atje, a do të shkoni vetëm?  
 Po, në qoftë se shkoj unë atje, do të shkoj vetëm.
- Në shkofshi ju atje, a do të shkoni vetëm?  
 Po, në shkofsha unë atje, do të shkoj vetëm.
- Në shkoftë ai atje, a do të shkojë vetëm?  
 Po, në shkoftë ai atje, do të shkojë vetëm.
- Në shkofshim na atje, a do të shkojmë vetëm?  
 Po, në shkofshim na atje, do të shkojmë vetëm.
- Në shkofsha unë atje, a do të shkoj vetëm?  
 Po, në shkofsh ti atje, do të shkojsh vetëm.
- Në shkofshin ata atje, a do të shkojnë vetëm?  
 Po, në shkofshin ata atje, do të shkojnë vetëm.
- b. Në qoftë se merrni letër, a do t'i përgjigjni?  
 Po, në qoftë se marr letër, do t'i përgjegj.
- Në marrshi letër, a do t'i përgjigjni?  
 Po, në marrsha letër, do t'i përgjegj.
- Në marrtë ai letër, a do t'i përgjegji?  
 Po, në marrtë ai letër, do t'i përgjegji.
- Në marrshim na letër, a do t'i përgjegjim?  
 Po, në marrshim na letër, do t'i përgjegjim.
- Në marrsha unë letër, a do t'i përgjegj?  
 Po, në marrsh ti letër, do t'i përgjegjesh.
- Në marrshin ata letër, a do t'i përgjegjin?  
 Po, në marrshin ata letër, do t'i përgjegjin.
- c. Në qoftë se vîni vonë, a t'a mbyll derën?  
 Po, në qoftë se vîj vonë, mbyllnie derën?
- N'ardhsh vonë, a t'a mbyll derën?  
 Po, n'ardhsha vonë, mbyllnie derën.

LESSON 58

N'ardhtë vonë, a t'a mbyll derën?  
Po, n'ardhtë vonë, mbyllnie derën.

N'ardhshim vonë, a t'a mbyllim derën?  
Po, n'ardhshim vonë, mbyllnie derën.

N'ardhsh ti vonë, a t'a mbyll derën?  
Po, n'ardhsha unë vonë, mbylle derën.

N'ardhshin ata vonë, a t'a mbyll derën?  
Po, n'ardhshin ata vonë, mbyllnie derën.

d. Në qoftë se bleni automobil, a do t'a bleni të rí?  
Po, në qoftë se blëj automobil, do t'a blëj të rí.

Në blefshi automobil, a do t'a bleni të rí?  
Po, në blefsha automobil, do t'a blëj të rí.

Në bleftë ai automobil, a do t'a blejë të rí?  
Po, në bleftë ai automobil, do t'a blejë të rí.

Në blefshim na automobil, a do t'a blejmë të rí?  
Po, në blefshim na automobil, do t'a blejmë të rí.

Në blefsh ti automobil, a do t'a blejsh të rí?  
Po, në blefsha unë automobil, do t'a blëj të rí.

Në blefshin ata automobil, a do t'a blejnë të rí?  
Po, në blefshin ata automobil, do t'a blejnë të rí.

2.  
a. Në qoftë se shkoni atje, a do të shkoni vetëm?  
Po, në qoftë se shkoj atje, do të shkoj vetëm.

Po shkuet ju atje, a do të shkoni vetëm?  
Po, po shkova unë atje, do të shkoj vetëm.

Po shkoi ai atje, a do të shkojë vetëm?  
Po, po shkoi ai atje, do të shkojë vetëm?

Po shkuem na atje, a do të shkojmë vetëm?  
 Po, po shkuem na atje, do të shkojmë vetëm.

Po shkove ti atje, a do të shkojsh vetëm?  
 Po, po shkova unë atje, do të shkoj vetëm.

Po shkuen ata atje, a do të shkojnë vetëm?  
 Po, po shkuen ata-atje, do të shkojnë vetëm?

b. Në qoftë se merrni letër, a do t'i përgjigjni?  
 Po, në qoftë se marr letër, do t'i përgjegj.

Po morët letër, a do t'i përgjigjni?  
 Po, po mora letër, do t'i përgjegj.

Po mori letër, a do t'i përgjegji?  
 Po, po mori letër, do t'i përgjegji?

Po more letër, a do t'i përgjegjish?  
 Po, po mora letër, do t'i përgjegj.

Po m. rën letër, a do t'i përgjegjim?  
 Po, po morëm letër, do t'i përgjegjim.

Po morën letër, a do t'i përgjegjin?  
 Po, po morën letër, do t'i përgjegjin.

c. Në qoftë se vîni vonë, a t'a mbyll derën?  
 Po, në qoftë se vîj vonë, mbyllnie derën.

Po erdhët ju vonë, a t'a mbyll derën?  
 Po, po erdha unë vonë, mbyllnie derën.

Po erdhe ti vonë, a t'a mbyll derën?  
 Po, po erdha unë vonë, mbylle derën.

Po erdhëm na vonë, a t'a mbyllim derën?  
 Po, po erdhëm na vonë, mbyllnie derën.

Po erdhi ai vonë, a t'a mbyll derën?  
 Po, po erdhi ai vonë, mbyllnie derën.

Po erdhën ata vonë, a t'a mbyll derën?  
 Po, po erdhën ata vonë, mbyllnie derën.

LESSON 58

Po erdha vonë, a duhet t'a mbyllni derën?  
Po, po erdhët vonë, unë duhet t'a mbyll derën.

- d. Në qoftë se bleni automobil, a do t'a bleni të rí?  
Po, në qoftë se blëj automobil, do t'a blëj të rí.

Po bletë automobil, a do t'a bleni të rí?  
Po, po bleva automobil, do t'a blëj të rí.

Po bleu ai automobil, a do t'a blejë të rí?  
Po, po bleu ai automobil, do t'a blejë të rí.

Po blemë na automobil, a do t'a blejmë të rí?  
Po, po blemë na automobil, do t'a blejmë të rí.

Po bleve ti automobil, a do t'a blejsh të rí?  
Po, po bleva unë automobil, do t'a blëj të rí.

Po blenë ata automobil, a do t'a blejnë të rí?  
Po, po blenë ata automobil, do t'a blejnë të rí.

3.

- a. A jeni mâ mirë sot?  
Po, sot jam mâ mirë.

A ju duket vetja mâ mirë sot?  
Po, sot më duket vetja mâ mirë.

Qysh më duket vetja mue sot?  
Jú ju duket vetja mâ mirë sot.

Po tý qysh të duket vetja sot?  
Edhe mue më duket vetja mâ mirë sot.

Qysh na duket vetja né sot?  
Né na duket vetja mâ mirë sot.

A i pëlqen vetja asaj vajze shumë?  
Po, asaj vajze i pëlqen vetja shumë.

Kujt i pëlqen vetja shumë?  
Asaj vajze i pëlqen vetja shumë.

A ju duket vetja i madh kur pini çibuk?  
Po, mue më duket vetja i madh kur pij çibuk.

Qysh ju duket vetja kur pini çibuk?  
Mue më duket vetja i madh kur pij çibuk.

Po atij, a i duket vetja i madh kur pi çibuk?  
Po, edhe atij i duket vetja i madh kur pi çibuk.

Qysh të duket tÿ vetja kur pi çibuk?  
Mue më duket vetja i madh kur pij çibuk.

b. A i thoni ju vetes ndonjiherë se keni bâ keq?  
Po, unë i thom vetes nganjiherë se kam bâ keq.

Kush i thotë vetes ndonjiherë se ka bâ keq?  
Na i thomi vetes nganjiherë se kemi bâ keq.

Çka i thonë ata vetes nganjiherë?  
Ata i thonë vetes nganjiherë se kanë bâ keq.

Kur bâni mirë, a i thoni vetes se keni bâ mirë?  
Po, kur bâj mirë i thom vetes se kam bâ mirë.

Qysh i thoni vetes kur bâni mirë?  
Kur bâj mirë i thom vetes se kam bâ mirë.

Kur i thoni vetes se keni bâ mirë?  
Kur bâj mirë i thom vetes se kam bâ mirë.

Çka i thoni vetes se keni bâ kur keni bâ mirë?  
Kur kam bâ mirë i thom vetes se kam bâ mirë.

Çka i thoni vetes se keni bâ kur keni bâ keq?  
Kur kam bâ keq i thom vetes se kam bâ keq.

Kur i thoni vetes se keni bâ keq?  
Kur kam bâ keq i thom vetes se kam bâ keq.

A i thonë të gjithë vetes se kanë bâ keq kur bâjnë keq?

Jo, të gjithë nuk i thonë vetes se kanë bâ keq kur bâjnë keq.

A i preu rrobaqepsi edhe vetes një palë rrobe?  
Po, rrobaqepsi i preu edhe vetes një palë rrobe.

LESSON 58

Kush i preu edhe vetes një palë rrobe?  
Rrobaqepsi i preu edhe vetes një palë rrobe.

Çka i preu vetes rrobaqepsi?  
Rrobaqepsi i preu vetes një palë rrobe.

Mbasi ju qiti me pi ju, a i qiti edhe vetes?  
Po, mbasi na qiti me pi ne, ai i qiti edhe vetes.

Kujt i qiti me pi, mbasi ju qiti ju?  
Mbasi na qiti ne, i qiti vetes me pi.

A e shifni veten në pasqyrë çdo mëngjes?  
Po, unë e shof veten në pasqyrë çdo mëngjes.

Kush e shof veten në pasqyrë çdo mëngjes?  
Unë e shof veten në pasqyrë çdo mëngjes.

Po ata, a e shofin veten në pasqyrë çdo mëngjes?  
Po, edhe ata e shofin veten në pasqyrë çdo mëngjes.

Çka shifni ju në pasqyrë çdo mëngjes?  
Na e shofim veten në pasqyrë çdo mëngjes.

A e shani veten ndonjiherë?  
Jo, unë nuk e shaj veten kurr.

Kush nuk e shan veten?  
Unë nuk e shaj veten.

A e përmbani ju veten kur zemroheni?  
Po, unë e përmbaj veten kur zemrohem?

Çka bân ai kur zemrohet?  
Ai e përmban veten kur zemrohet.

Çka duhet të bëjmë na të gjithë kur zemrohemi?  
Na të gjithë duhet t'a përmbajmë veten kur zemrohemi.

A e përmbajmë na gjithëmonë veten kur zemrohemi?  
Jo, na nuk e përmbajmë veten gjithmonë kur zemrohemi.

4. A e keni shkruar ju vetë detyrën e shtëpis?  
Po, unë vetë e kam shkruar detyrën e shtëpis.

A e ka shkruar ai vetë detyrën e shtëpis?  
Po, ai vetë e ka shkruar detyrën e shtëpis.

A e keni ndrequr ju vetë automobilin?  
Po, unë vetë e kam ndrequr automobilin.

A e ka harruar ai vetë portofolin në syzë?  
Po, ai vetë e ka harruar portofolin në syzë.

A e keni lënë ju vetë derën hapët?  
Po, unë vetë e kam lënë derën hapët.

A i kemi lënë na vetë dritoret hapët?  
Po, na vetë i kemi lënë dritoret hapët.

Në plazhën e Durrësit

(N'agjencin e autobusavet)

1. Dy bileta, vajtje e ardhje, për në plazhën e Durrësit ju lutem!
2. Ndër ditë pune s'ka autobusa që shkojnë nga Tirana drejt për drejt në plazhë.
3. Me të vërtetë e keni, apo doni me bâ shaka?
4. Jo, nuk bâj shaka; vetëm ndër ditë pushimi ka autobusa për në plazhë.
5. Si bâhet atëherë me shkue atje?
6. Shkoni në Durrës. Atje ka maqina që nisen orë e çast për në plazhë.
7. Sa larg është plazha nga qendra e qytetit?
8. Plazha vetë është e gjatë disa kilometra; mvaret nga ku doni me shkue.
9. Ke hoteli Adriatik; atje afër më kanë thënë se ka kabina me dush të nxehët.
10. Nja 6 km. Po deshët me shkue në Durrës hypni n'autobus se gati po niset.
11. Po biletat?
12. Ju a pret shoferi n'autobus. Hypni shpejt se u-vonuet!

(Në Durrës)


13. Shofer! Shofer! E paska zënë gjumi!
14. Jo, nuk më ka zënë gjumi, por nuk e ndiej veten mirë. Ç'doni?
15. Desha të dij në se është kjo një nga maqinat që shkon për në plazhë.
16. Kjo vetë është, por s'keni zgjedhë një ditë të përshtatshme me shkue me u-lá.

17. Përkundrazi. Mue më duket një ditë e rrahët e plot diell.
18. Do t'a shifni vetë kur të shkoni atje; fryn erë e madhe dhe deti ka dallgë shumë.
19. S'ka rëndësi! Në mos mundsha me notue do të bëj banja dielli.
20. Paçi veten më qafë! Do të ju verbojë rana.

(Në plazhë)

21. Due një kabinë për dy vetë, një palë brekë banje dhe dy peshqirë.
22. Mirë, por sot është e rrezikshme me u-lá, prandej është e ndalueme me hy në det.
23. Po në diell, a është e lejueshme me ndejtë?
24. Po, në diell mund të rrini sa të doni.

# LESSON 58



At the Beach of Durrës

(at the bus agency)

1. Two round-trip tickets to Durrës beach, please.
2. There are no direct buses (that go) from Tirana to the beach on workdays.
3. Are you serious or joking?
4. No, I am not joking. There are buses that go to the beach only on holidays.
5. How can I get there?
6. Go to Durrës. In Durrës there are buses that go to the beach continually.
7. How far is the beach from downtown?
8. The beach is very long, several kilometers, so it depends on where you want to go.
9. The Adriatic Hotel. I have been told that nearby are cabins with hot showers.
10. About six kilometers away. If you want to go to Durrës, get on this bus because it's ready to leave.
11. What about the tickets?
12. You will buy them from the driver on the bus. Get on it before it's too late.

(at Durrës)

13. Driver! Driver! Why, he has fallen asleep!
14. No, I am not asleep, but I am not feeling well. What do you want?
15. I wanted to know if this is one of the buses that goes to the beach.
16. This is it, but you haven't picked a suitable day to go swimming.

LESSON 58

17. On the contrary. It's a warm and sunny day.
18. You will see when you get there. It's windy and the sea is very rough.
19. It doesn't matter. If I can't swim I will stay in the sun.
20. The sand will blind you and you will have only yourself to blame.

(at the beach)

21. I want a cabin for two, one pair of trunks and two towels.
22. Fine, but today is dangerous for swimming, therefore, it's prohibited to go into the water.
23. Is it permissible to stay in the sun?
24. Yes, you can stay in the sun as much as you like.

THE PRONOUN - vete-vetja

- a. The pronoun vete-vetja is declined as a feminine noun, but the adjective agrees with the noun it qualifies. Examples:

Atij i duket vetja i rëndësishëm.  
(He thinks he is important.)

Asaj i duket vetja e bukur.  
(She thinks she is pretty.)

- b. The pronoun vete-vetja is used only in the singular, but it can refer to a noun in the plural too. Examples:

Ai e mban veten fajtuer.  
(He considers himself guilty.)

Ata e mbajnë veten fajtorë.  
(They consider themselves guilty.)

- c. It is used in the indefinite form when it is the object of a preposition. Examples:

Këtë libër e bleva për vete.  
(I bought this book for myself.)

S'e kam portofolin me vete.  
(I don't have my wallet with me.)

Ai s'është në vete.  
(He is out of his mind.)(not in his senses)

The preposition nga, rarely used, governs the nominative of the definite form and the reflexive pronoun is usually followed by a possessive adjective. Example:

Këtë e ke nga vetja jote.  
(You did it to yourself.)

- d. In other cases the reflexive pronoun is used in the definite form. Examples:

Shif veten, jo mue.  
(Look at yourself, don't look at me.)

I rá vetes me grusht.  
(He hit himself with his fist.)

Ata i thonë vetes guximtarë.  
(They consider themselves courageous.)

E ka nxjerrë prej vetes.  
(He has invented it by himself.)

#### THE PRONOUN - vetë

The pronoun vetë is usually used to emphasize the subject (a personal pronoun singular or plural, a demonstrative pronoun or a noun). Examples:

Unë vetë e kam pá.  
(I myself saw it.)

Na vetë i thamë me ardhë.  
(We ourselves told him to come.)

Ministri vetë nuk erdhi, por dërgoi një përfaqësues.  
(The minister himself didn't come but sent someone to represent him.)

Vetë deshën me ndejtë.  
(They themselves wanted to stay.)

#### THE OPTATIVE AND THE SIMPLE PAST USED IN CONDITIONAL SENTENCES

- a. The optative--the verb form used for expressing good wishes, congratulations, blessings, or curses and damnations--may also be used when preceded by në to set a condition. Examples:

Në shkofsha do të shkoj vetëm.  
(If I go, I'll go alone.)

Në ndejtshin deri n'orën 6 duhet t'i mbajmë për darkë.

(If they stay until 6 o'clock we should have them stay for dinner.)

- b. The simple past also may set a condition if preceded by "po."

Po shkova do të shkoj vetëm.

(If I go I'll go alone.)

Po ndejtën deri n'orën 6 duhet t'i mbajmë për darkë.

(If they stay until 6 o'clock we should have them stay for dinner.)

1. A i duket atij vetja njeri me rëndësi?  
Po, atij i duket vetja njeri me rëndësi.

Kujt i duket vetja njeri me rëndësi?  
Atij i duket vetja njeri me rëndësi.

Si i duket vetja atij?  
Atij i duket vetja njeri me rëndësi.

A ju duket vetja mâ mirë sot?  
Po, sot më duket vetja mâ mirë.

Kujt i duket vetja mâ mirë sot?  
Mue më duket vetja mâ mirë sot.

Po atij, a i duket vetja mâ mirë sot.  
Po, edhe atij i duket vetja mâ mirë sot.

A është ai i zoti i vetes për çdo gjë?  
Po, ai është i zoti i vetes për çdo gjë.

Kush është i zoti i vetes për çdo gjë?  
Ai është i zoti i vetes për çdo gjë.

Për çka është i zoti i vetes ai?  
Ai është i zoti i vetes për çdo gjë.

A i rá ai vetes pa dashë?  
Po, ai i rá vetes pa dashë.

Kush i rá vetes pa dashë?  
Ai i rá vetes pa dashë.

Çka bâni ai pa dashë?  
Ai i rá vetes pa dashë.

A e ndieni veten mâ mirë sot?  
Po, unë e ndiej veten mâ mirë sot.

Kush e ndien veten mâ mirë sot?  
Ai e ndien veten mâ mirë sot.

Si e ndieni ju veten sot?  
Na e ndiejmë veten mâ mirë sot.

Cilët e ndiejnë veten më mirë sot?  
Ata e ndiejnë veten më mirë sot.

A ju a dha të hollat prej vetes apor prej arkës së shoqnis?

Jo, m'i dha prej vetes sepse arka e shoqnis s'kishte asnji lek.

Kush m'i dha të hollat prej vetes e jo prej arkës së shoqnis?

Ai ju a dha të hollat prej vetes e jo prej arkës së shoqnis.

Kujt i a dha ai të hollat prej vetes e jo prej arkës së shoqnis?

Ai m'i dha të hollat mue prej vetes e jo prej arkës së shoqnis.

Çka ju dha ai prej vetes?

Ai m'i dha të hollat prej vetes.

2. A ju a tha ai vetë apor e keni ndigjue prej ndokujt?

Jo, m'a tha ai vetë.

A shkuet ju vetë apor dërguet njeri?

Jo, shkova vetë.

Po ai, a shkoi vetë apor dërgoi njeri?

Jo, ai shkoi vetë.

A do të flitni ju vetë me të apor do t'i shkrueni?  
Jo, do të flasim vetë me të.

Po ata, a do të flasim vetë me të apor do t'i shkruajnë?

Jo, ata do të flasim vetë me të.

3. Në shkofsha unë, a do të vîni edhe ju?

Po, në shkofshi ju do të vîjmë edhe na.

Në shkofsh ti, a të vîj edhe unë?

Po, në shkofsha unë hajde edhe ti.

LESSON 58

Në shkofhtë ai, a do të shkoni edhe ju?  
Po, në shkofhtë ai do të shkoj edhe unë.

Në shkofshi në S.F., a mund të vîj edhe unë  
me jû?  
Po, në shkofshim në S.F. hajdeni edhe ju me në.

Në shkofshin ata, a do të shkoni edhe ju?  
Po, në shkofshin ata do të shkojmë edhe na.

A të filloj nga puna, n'ardhsha mâ heret?  
Po, n'ardhsh mâ heret, fillo nga puna.

N'ardhtë ai, a t'i thom që të vîjë me ju pá?  
Po, n'ardhtë, thoni që të vîjë me më pá.

N'ardhshim mâ heret, a të fillojmë me hangër  
pá jû?  
Po, n'ardhshi mâ heret, filloni me hangër.

N'ardhshin ata vonë, a t'u thom gjâ?  
Jo, n'ardhshin vonë, mos u thoni gjâ.

Në mos shkofshi në S. F., a mund të vîj me ju pá?  
Po, në mos shkofsha në S.F. hajdeni me më pá.

Në mos shkofhtë ai, a do të shkojsh ti?  
Jo, në mos shkofhtë ai, s'shkoj as unë.

Në mos shkofshi në S.F., a mund të na e epni  
automobilin?  
Po, në mos shkofshim në S.F. do t'u a apim  
automobilin.

Në mos shkofshin ata, a do të shkoni ju?  
Jo, në mos shkofshin ata, s'shkojmë as na.

4. Po shkova, a t'i thom Qazimit se kam folë me jû?  
Po, po shkuet thoni Qazimit se keni folë me mue.

Po shkoi ai, a t'i ap automobilin tuej?  
Po, po shkoi ai epni automobilin tim.

Po shkuem në L.A., a të shkojmë me tren?  
Po, po shkuet në L.A. shkoni me tren.

Po shkuen ata, a do të shkojnë heret?  
Po, po shkuen ata do të shkojnë heret.

Po erdhi ai, a t'i thom që të presi?  
Po, po erdhi ai thoni që të presi.

Po erdhëm heret, a duhet të fillojmë nga puna menjihërë?  
Po, po erdhët heret filloni nga puna menjihërë e shkoni në shtëpi më heret.

Po erdhën ata, a t'u thom që të shkojnë ke drejtori?  
Po, po erdhën ata thoni që të shkojnë ke drejtori.

5. A i zgjidhni ju vetë rrobet, apor ju ndihmon ndokush?  
Jo, i zgjedh vetë.

Kush i zgjedh rrobet vetë?  
Ju i zgjidhni rrobet vetë.

Po ai, a i zgjedh rrobet vetë, apor i ndihmon grueja?  
Jo, ai i zgjedh rrobet vetë.

A i zgjidhni pemët një nga një apor i bleni ashtu pa i shikue mirë?  
Jo, na i zgjedhim pemët një nga një.

Po ata, si i blejnë pemët?  
Edhe ata i zgjedhin një nga një.

A e zgjedhe vetë kravatën, apor të ndihmoj ndokush?  
Jo, e zgjodha vetë.

Kush e zgjodhi vetë kravatën?  
Ai e zgjodhi vetë kravatën.

A i zgjodhët ju vetë rrobet, apor ju ndihmoj ndokush?  
Jo, na i zgjodhëm vetë rrobet.

Cilët i zgjodhën vetë rrobet?  
Ata i zgjodhën vetë rrobet.

A e zgjidhni ju kujdestarin e klasës, apor e zgjedh shkolla?

Shkolla e zgjedh kujdestarin e klasës.

Kush e zgjedh kujdestarin e klasës?

Shkolla e zgjedh kujdestarin e klasës.

A i zgjidhni ju kujdestarët e klasavet?

Jo, na nuk i zgjedhim kujdestarët e klasavet.

Po ata, a i zgjedhin kujdestarët e klasavet?

Jo, as ata nuk i zgjedhin kujdestarët e klasavet.

A e zgjodhët ju sekretarin e shoqnis?

Po, na e zgjodhëm sekretarin e shoqnis.

Po ata, a e zgjodhën sekretarin e shoqnis?

Po, edhe ata e zgjodhën sekretarin e shoqnis.

6. A është e lejueshme me pî duhan në klasë?  
Jo, nuk është e lejueshme me pî duhan në klasë.

Ku nuk është e lejueshme me pî duhan?

Në klasë nuk është e lejueshme me pî duhan.

Çka nuk është e lejueshme me bâ në klasë?

Nuk është e lejueshme me pî duhan në klasë.

A është e lejueshme me dalë andej lumit?

Po, është e lejueshme me dalë andej lumit.

Ku është e lejueshme me dalë?

Asht e lejueshme me dalë andej lumit.

7. A është e ndalueme me folë me zâ të naltë në bibliotekë?

Po, në bibliotekë është e ndalueme me folë me zâ të naltë.

Ku është e ndalueme me folë me zâ të naltë?

Në bibliotekë është e ndalueme me folë me zâ të naltë.

Çka është e ndalueme me bâ në bibliotekë?  
Në bibliotekë është e ndalueme me folë me zâ të  
naltë.

8. Sa vjetë shërbim keni n'ushtrí?  
Unë kam 10 vjetë shërbim n'ushtrí.

Kush ka 10 vjetë shërbim n'ushtrí?  
Unë kam 10 vjetë shërbim n'ushtrí.

Po ai, sa vjetë shërbim n'ushtrí ka?  
Edhe ai ka 10 vjetë shërbim n'ushtrí.

A është i mirë shërbimi me autobus Tiranë-Korçë?  
Po, shërbimi me autobus Tiranë-Korçë është i mirë.

Cili shërbim me autobus është i mirë?  
Shërbimi me autobus Tiranë-Korçë është i mirë.

Si është shërbimi me autobus Tiranë-Korçë?  
Shërbimi me autobus Tiranë-Korçë është i mirë.

9. A ka lëvizje të madhe automobilash n'at rrugë?  
Po, n'at rrugë ka lëvizje të madhe automobilash.

Në cilën rrugë ka lëvizje të madhe automobilash?  
N'at rrugë ka lëvizje të madhe automobilash.

10. A është i qetë deti sot për të bâ banja?  
Po, deti sot është i qetë për të bâ banja.

Si është deti sot për të bâ banja?  
Deti sot është i qetë për të bâ banja.

11. A shtrihen ndonjiherë në shtrat gjatë ditës  
kur jeni i lodhun?  
Po, kur jam i lodhun nganjherë shtrihem në  
shtrat gjatë ditës.

Kush shtrihet në shtrat nganjherë gjatë ditës  
kur është i lodhun?  
Ju shtrihen në shtrat nganjherë gjatë ditës  
kur jeni i lodhun.

LESSON 58

Po ai, a shtrîhet ndonjiherë në shtrat gjatë ditës kur është i lodhur?

Po, edhe ai shtrîhet nganjherë në shtrat gjatë ditës kur është i lodhur.

12. A zbresin aeroplanat në S.F. kur ka shumë mjegull?  
Jo, kur ka shumë mjegull aeroplanat nuk zbresin në S.F.

Kur nuk zbresin aeroplanat në S.F.?

Kur ka shumë mjegull aeroplanat nuk zbresin në S.F.

Pesë ditë më parë më kanë fillue pushimet vjetore, prandej pardje vendosa të shkoj e të kaloj një ditë në plazhën e Durrësit. Thash me vete se do t'ishte më mirë me shkue gjatë ditëve të punës sepse të dielevet ka shumë popull. Kështu pra mora çantën e futa në të brekët e banjës, dy peshqirë e një libër; mora syzet e diellit e shkova në agjencinë e autobusave. Kur i kërkova nëpunësit një biletë vajtje e ardhje më tha se, gjatë ditëve të punës nuk ka shërbim të drejtpërdrejtë nga Tirana në plazhën e Durrësit. Më tha se së pari duhet të shkojshem në Durrës e atje të merrshem autobusin për në plazhë. Më tha se nga Durrësi ka orë e çast automobila për në plazhë.

Pothuej mbas një ore që u-nisa nga Tirana merrja në Durrës ku menjherë gjeta autobus për në plazhë. Porsa zbrita nga autobusi ndigjova se dikush po më thërritte. Këtheva kryet e pashë një nga shokët e fabrikës ku punoj unë. Mbasi u-përshëndetëm më dha çelsin e kabinës së tij e më tha se nuk ishte nevoja të merrshem një kabinë tjetër me qirafë. Si u-çvesha, dola e u-shtrina para kabinës ku ishte edhe

shoku. Rana ishte e ngrofët, deti ishte fare i qetë e në plazhë nuk kishte shumë lëvizje. Ishte tamam një ditë për të pushue.

---

QUESTIONS-PYETJE

1. Kujt i kanë fillue pushimet vjetore pesë ditë më parë?
2. Kush vendosi pardje të shkojë e të kalojë një ditë në plazhë?
3. Ku ka shumë popull të dielevet?
4. Kush mori çantën e futi në të brekët e banjës, dy peshqirë etj.?
5. Çfarë syzesh mora?
6. Në cilën agjenci shkova?
7. Kujt i kërkova një biletë vajtje e ardhje për në plazhë?
8. Kush më tha se gjatë ditëve të punës nuk kishte shërbim të drejtpërdrejtë nga Tirana në plazhë?
9. Kur nuk ka shërbim të drejtpërdrejtë nga Tirana në plazhë?
10. Ku duhet të shkojshem së pari e atje të merrshem autobusin për në plazhë?
11. Çka ka nga Durrësi orë e çast për në plazhë?
12. Mbas sa kohe që u-nisa nga Tirana mrrijta në Durrës?
13. Ku mrrijta mbas pothuej një ore që u-nisa nga Tirana?

LESSON 58

14. Kur gjeta autobus nga Durrësi për në plazhë?
15. Çka ndigjova porsa zbrita nga autobusi?
16. Kur ndigjova se dikush po më thërritte?
17. Kë pashë kur këtheva kryet?
18. Ku punonte shoku që po më thërritte kur zbrita nga maqina?
19. Çelsin e cilës kabinë më dha shoku, mbasi u-përshëndetëm?
20. Kush më tha se nuk ishte nevoja të merrshem një kabinë tjetër me qirá?
21. Kush doli e u-shtrif para kabinës mbasi u-çvesh?
22. Qysh ishte rana?
23. Si ishte deti?
24. Ku nuk kishte shumë lëvizje?
25. Çfarë dite ishte?

PJESA E GJASHTË  
DETYRË SHTËPIJE

LESSON 58  
PART VI  
HOMEWORK

- A. There are, in Albanian, at least three forms of conditional sentences which convey the same meaning. Using the underlined form as an example, write in the other two forms.

Në goftë se mbaroj - Po mbarova - Në mbarofsha

1. Në goftë se shkoj do të nisem sonte.
  - a. \_\_\_\_\_
  - b. \_\_\_\_\_
2. Në goftë se më shef tue folë me atë do të zemrohet.
  - a. \_\_\_\_\_
  - b. \_\_\_\_\_
3. Në goftë se nuk shkojmë do t'ishte mirë me i telefonue së paku një ditë më parë.
  - a. \_\_\_\_\_
  - b. \_\_\_\_\_
4. Në goftë se ata nuk janë atje unë nuk do të hËj mbrendë.
  - a. \_\_\_\_\_
  - b. \_\_\_\_\_

B. Translate the following:

1. I don't know whether smoking is allowed.
2. He wants to ask questions all the time.
3. When he starts talking, I always fall asleep.
4. All of us like to joke with each other.
5. I was late (use the verb to be late) because I woke up late.

LESSON 58  
PART VII  
VOCABULARY

PJESA E SHTATË  
FJALORI

arshje, -a	(f.)	coming (as noun)
çerekë, -t	(f.)	shorts, briefs, drawers, trunks
dallgë, -a dallgë, -t	(f.)	wave
drejt për drejt	(adv.)	directly
i, e, të drejtpërdrejtë të drejtpërdrejta	(adj. m. & f.)	direct
dush, -i dushe, -t	(m.)	shower
kilometër kilometri kilometra, -t	(m.)	kilometer
me u-lá (unë lahem)	(v.)	to wash oneself, to swim
i, të lejueshëm e, të lejueshme	(adj. m. & f.)	permissible
lëvizje, -a lëvizje, -t	(f.)	movement, traffic
maquinë, -a maqina, -t	(f.)	machine, automobile
me u-mvarë (unë mvarem)	(v.)	to depend (on); to be under the jurisdiction or authority of
i, të ndaluem e, të ndalueme	(adj. m. & f.)	forbidden, pro- hibited, banned
në se	(conj.)	whether, if

LESSON 58

i, e, të qetë të qeta	(adj. m. & f.)	quiet, calm, still, peaceful
ranë, -a	(f.)	sand
syze, -t	(f.)	glasses, spectacles
shaka, -ja shaka, -t	(f.)	joke
shërbim, -i shërbime, -t	(m.)	service
me u-shtrî (unë shtrîhem)	(v.)	to lie down, to stretch oneself, to sprawl
vajtje, -a	(f.)	going (as noun)
me verbue (unë verboj)	(v.)	to blind, to become blind
vjetuer, vjetore	(adj.)	annual, yearly
me u-vonue (unë vonohem)	(v.)	to delay, to be tardy, to be late
me zbritë (unë zbres)	(v.)	to get down, to go down, to bring down, to take down, to lower, to des- cend; to deduct, to subtract; to dis- mount, to climb down, to come down
me zgjedhë (unë zgjedh)	(v.)	to choose, to elect, to select, to pick out

Shenime:

Si bâhet?

What can one do?

LESSON 58

orë e çast

all the time, continually

Paçi veten në qafë!

blame yourself (yourselves)

me për një biletë

to buy a ticket

vajtje e ardhje

round trip

Me të vërtetë e keni?

You really mean it?  
Are you serious?

me bën shaka

to joke, to kid

deti ka dallgë shumë

the sea is very rough.

PJESA E PARË  
USHTRIMË GRAMATIKORE PARAPRAKE-GRAMMAR PERCEPTION DRILL

LESSON 59

PART I

1.

a. A është vllai im mësues?  
Po, vllai juej është mësues.

A është edhe vllai yt mësues?  
Po, edhe vllai im është mësues.

A është im vllá mësues?  
Po, yt vllá është mësues.

A është yt vllá oficer?  
Po, im vllá është oficer.

A është baba yt punëtuer?  
Po, baba im është punëtuer.

A është yt át punëtuer?  
Po, im át është punëtuer.

A është yt ungj mjek?  
Po, im ungj është mjek.

A është djali yt nxânës?  
Po, djali im është nxânës.

A është yt bîr nxânës?  
Po, im bîr është nxânës.

A është im kushrî oficer?  
Po, yt kushrî është oficer.

A është yt nip student?  
Po, im nip është student.

A thotë grueja shqiptare zakonisht për burrin e saj: "Im shoq"?  
Po, grueja shqiptare zakonisht thotë për burrin e saj: "Im shoq."

Çfarë fjalësh përdor grueja shqiptare për të tregue burrin e saj?  
Për të tregue burrin e saj grueja shqiptare zakonisht përdor fjalët "Im shoq."

- b. A është ky libri i vllait tim?  
Po, ai është libri i vllait tând.
- A thash unë: "Ky është libri i tim vllá?"  
Po, ti thé: "Ky është libri i tim vllá."
- A është ai fjalori i tyt vllá?  
Po, ai është fjalori i tim vllá.
- A është ai automobili i tyt et?  
Po, ai është automobili i tim et.
- A është ajo kapela e tyt nip?  
Po, ajo është kapela e tim nip.
- A është ai lapsi i tyt bír?  
Po, ai është lapsi i tim bír.
- c. A i a dhé librin tim vllá?  
Po, unë i a dhash librin tyt vllá.
- A i thé tyt bír me ardhë me né?  
Po, unë i thash tim bír me ardhë me né.
- Po tim nip, a i the me u-bâ gati?  
Po, edhe tyt nip i thash me u-bâ gati.
- Po tyt kushrî, a i thé me u-bâ gati?  
Po, edhe tim kushrî i thash me u-bâ gati.
- A i a dhé të hollat tyt shoq sot në mëngjes?  
Po, unë i a dhash të hollat tim shoq sot në mëngjes.
- Po tim kushrî, a s'i dhé gjâ?  
Jo, tyt kushrî s'i dhash gjâ.
- A i a këtheu ai të hollat tyt ungj?  
Jo, ai nuk i a këtheu të hollat tim ungj.
- d. A shkove mbrâmë në kinema me vllán tând?  
Po, mbrâmë shkova në kinema me vllán tim.
- A shkove mbrâmë në kinema me têt vllá?  
Po, mbrâmë shkova në kinema me tim vllá.

A shkoi ai mbrâmë me tim vllá në teatër?  
Po, ai shkoi mbrâmë me tët vllá në teatër.

A erdhën ata për t'a vizitue tët ungj?  
Po, ata erdhën për t'a vizitue tim ungj.

Po tët át, a nuk e vizituen?  
Po, ata e vizituen edhe tim át.

A e vizituen edhe tët bír?  
Jo, tim bír nuk e vizituen.

e. A ke marrë ndonji letër prej vllait tim?  
Po, unë kam marrë nji letër prej vllait tând.

A ke marrë ndonji letër prej tim vllá?  
Po, unë kam marrë nji letër prej tyt vllá.

Prej kujt ke marrë letër?  
Unë kam marrë letër prej tyt vllá.

A e bleu ai shtëpín prej tyt kushrî?  
Po, ai e bleu shtëpín prej tim kushrî.

Çka bleu ai prej tyt kushrî?  
Ai e bleu shtëpín prej tim kushrî.

Prej kujt e bleu ai shtëpín?  
Ai e bleu shtëpín prej tim kushrî.

A u-ndá ai prej tyt et dhe tyt nip?  
Po, ai u-ndá prej tim et dhe tim nip.

Kur u-ndá ai prej tyt et dhe tyt nip?  
Nuk e di kur u-ndá ai prej tim et dhe tim nip.

A u-largue ajo prej tyt bír dhe tyt kushrî?  
Po, ajo u-largue prej tim bír dhe tim kushrî.

Kush u-largue prej tyt bír dhe tyt kushrî?  
Ajo u-largue prej tim bír dhe tim kushrî.

- 2.
- a. A është motra ime mësuese?  
Po, motra jote është mësuese.
- A është edhe motra jote mësuese?  
Po, edhe motra ime është mësuese.
- A thash unë: "Ime motër është mësuese?"  
Po, ti thé: "Ime motër është mësuese."
- A është edhe jot'motër mësuese?  
Po, edhe ime motër është mësuese.
- Çka është ime motër?  
Jot'motër është mësuese.
- Çka është jot'motër?  
Ime motër është mësuese.
- A është nëna jote shtëpijake?  
Po, nëna ime është shtëpijake.
- A është jot'ëmë shtëpijake?  
Po, im'ëmë është shtëpijake.
- A është jot'mbesë nxânse?  
Po, ime mbesë është nxânse.
- A është edhe jot'bijë nxânse?  
Po, edhe ime bijë është nxânse.
- A qe ime kushrinë ke ju sot në mëngjes?  
Po, jot'kushrinë qe ke na sot në mëngjes.
- b. A është kjo çadra e sime motër, apo e sat'motër?  
Ajo është çadra e sat'motër dhe jo e sime motër.
- A është ai libri i sat'mbesë?  
Po, ai është libri i sime mbesë.
- A janë këto rrobet e sat'ëmë?  
Po, ato janë rrobet e sim'ëmë.
- Cilat janë rrobet e sat'ëmë?  
Ato janë rrobet e sim'ëmë.
- Ku janë librat e sime mbesë?  
Nuk e di ku janë librat e sat'mbesë.

A është ai lapsi i sat'kushrînë?  
 Jo, ai nuk është lapsi i sime kushrînë.

A është ajo çanta e sat'bijë?  
 Po, ajo është çanta e sime bijë.

E kujt është ajo çantë?  
 Ajo çantë është e sime bijë.

c. A i a dhë librin sime motër apo sat'motër?  
 Unë i a dhash librin sat'motër dhe jo sime motër.

A i thë sat'bijë me ardhë me në?  
 Po, unë i thash sime bijë me ardhë me në.

A i thë edhe sime mbesë me u-bâ gati?  
 Po, edhe sat'mbesë i thash me u-bâ gati.

Po sat'kushrînë, a nuk i the me u-bâ gati?  
 Po, edhe sime kushrînë i thash me u-bâ gati.

A i a dhë të hollat sat'shoqe sot në mëngjes?  
 Po, unë i a dhash të hollat sime shoqe sot në mëngjes.

Po sime kushrînë, a s'i thë gjâ?  
 Jo, sat'kushrînë nuk i thash gjâ.

d. A shkove ti mbrâmë në kinema me time motër apo me tët motër?  
 Unë shkova mbrâmë në kinema me time motër.

Kush shkoi mbrâmë në kinema me time motër?  
 Ai shkoi mbrâmë në kinema me tët motër.

A erdh mjeku për t'a vizitue tët âmë dje?  
 Po, mjeku erdh për t'a vizitue time âmë dje.

Po tët motër, a e vizitoi mjeku?  
 Jo, time motër nuk e vizitoi mjeku.

A shkon jot'motër në shkollë me tët mbesë?  
 Po, ime motër shkon në shkollë me time mbesë.

A është ai peshqesh për tët mbesë apo për time motër?  
 Ai peshqesh është për time mbesë dhe jo për tët motër.

- e. A ke marrë ndonji letër prej sat'motër?  
 Po, unë kam marrë shumë letra prej sime motër.
- A ke marrë ndonji letër prej sime motër?  
 Jo, prej sat'motër nuk kam marrë asnjë letër.
- A e more paqetën prej sime mbesë?  
 Po, unë e mora paqetën prej sat'mbesë.
- A e bleu ajo shtëpinë prej sat'kushrinë?  
 Po, ajo e bleu shtëpinë prej sime kushrinë.
- A u-ndë ai prej sat'mbesë?  
 Jo, ai nuk u-ndë prej sime mbesë.
- A e di pse u-largue ajo prej sat'bijë?  
 Jo, nuk e di pse u-largue ajo prej sime bijë.
- A ke marrë ndonji herë të holla prej sim'âmë?  
 Po, unë kam marrë shpesh të holla prej sat'âmë.


Berberi i vogël

1. Mirë dita, Faton! Ç'ke? Po më dukesh i mërzitun.
2. Jam nervoz sot. Më ka zemrue im bër.
3. Yt bër? Ai s'është veçse 8 vjeç; ç'të keqe është ai në gjendje me bën sa me të zemrue?
4. Çuditësh sikur t'a diësh çka ka bën.
5. Më kallxo pra çka ka bën!
6. Ka ca ditë që më thotë se do me u-bën berbër.
7. Gjithë fëmijët kanë dëshirë me u-bën diçka; të mija duen me u-bën zjarmfikës.
8. Sot, kur po flëjshim gjatë vapës, ka shkue në banjë dhe ka marrë veglat e rrojes.
9. Çka ka bën me to?
10. Hatën! Së pari, ka marrë gërshanën dhe u ka pré shpendëvet krahët.
11. O! Shejtani!
12. Mandej u ka pré bishtat lopëvet.
13. Punë e madhe! Për këtë je zemrue?
14. Ka edhe më. Ka shkue në thark dhe ka fillue me rrue derrat.
15. Si ka qenë i zoti me i mbajtë në vend, pa lëvizë?
16. Natyrisht që s'ka qenë i zoti! Prandej ka pré gishtat e edhe derrat.
17. Ke të drejtë me u-zemrue. Djali e paska teprue!
18. Përveç kësaj, më ka lënë pa gjumë. E gjithë lagja u-zgjue nga zhurma.
19. A i bërtite djalit?
20. A i bërtita? E rrafa sa do t'a mbajë mend për shumë kohë.

21. A qe e nevojshme me e çue ke mjeku?  
22. Jo. E âma më tha se nuk ishte pré shumë; ajo e mjekoi.  
23. S'ke ç'bân. Kështu e kanë fëmijët.



# LESSON 59




The Little Barber

1. Hello Faton! What's the matter? You look upset.
2. I am nervous today. My son has upset me.
3. Your son? He is only 8 years old. I wonder what he can do to make you mad.
4. You would be surprised if you knew what he has done.
5. Tell me, what has he done?
6. For some time he has been telling me that he wants to become a barber.
7. All children like to become something. Mine want to become firemen.
8. Today while I was taking a nap during siesta time, he had gone to the bathroom and taken my shaving kit.
9. What did he do with it?
10. A terrible thing. First he cut the wings of the fowl with scissors.
11. Oh! What a devil!
12. Then he cut the tails of the cows.
13. So what! For this you are mad?
14. There is more. He went to the pigpen and started to shave the pigs.
15. How was he able to hold them down?
16. Naturally he wasn't able to do so; that's why he has cut his fingers and the pigs also.
17. Of course, you are right to be angry. He has gone too far.
18. Besides, he didn't let me sleep. And all the neighborhood woke up from the noise.

LESSON 59

19. Did you scold him?  
20. Didn't I? I spanked him so much that he'll remember it for a long time.
21. Was it necessary to take him to the doctor?  
22. No. His mother told me that (he wasn't) the cut wasn't very (much) deep; she treated him.
23. What can you do! That's how children are.



Kërcimtarë nga Luma

POSSESSIVE ADJECTIVES PRECEDING NOUNS DENOTING FAMILY  
RELATIONSHIP (See also Lessons 37, 48, 55 and 56.)

The possessive adjectives im, ime, yt, jote may precede a noun only if the noun denotes a family relationship. Examples:

vllá:	im vllá, yt vllá
nip:	im nip, yt nip
babë:	im át, yt át
motër:	ime motër, jot'motër
mbesë:	ime mbesë, jot'mbesë
âinë:	im'âinë, jot'âinë

Declension:

FIRST PERSON

(Masculine Singular)

	<u>Regular</u>		<u>Irregular</u>
N.	im vllá		im át
G.	i, e, të tim vllá *	i, e, të	tim et
D.	tim vllá *		tim et
Ac.	tim vllá		tim át
Ab.	prej tim vllá *	prej	tim et

(Feminine Singular)

N.	ime motër		im'âinë
G.	i, e, të sime motër *	i, e, të	sim'âinë
D.	sime motër *		sim'âinë
Ac.	time motër		tim'âinë
Ab.	prej sime motër *	prej	sim'âinë

SECOND PERSON

(Masculine Singular)

N.	yt vllá		yt át
G.	i, e, të tyt vllá *	i, e, të	tyt et
D.	tyt vllá *		tyt et
Ac.	tët vllá		tët át
Ab.	prej tyt vllá *	prej	tyt et

SECOND PERSON

(Feminine Singular)

	<u>Regular</u>		<u>Irregular</u>
N.	jot'motër		jot'âmë
G.	i, e, të sat'motër *	i, e, të	sat'âmë
D.	sat'motër *		sat'âmë
Ac.	tët'motër		tët'âmë
Ab.	prej sat'motër *	prej	sat'âmë

Remarks:

1. As you see in the preceding tables, the noun is not declined. In a few Albanian grammar books they do decline the noun in the indefinite form (see asterisk). Examples: Nom. yt vllá, Gen. i, e, të tyt vëllai, and so on. People in every day speech do not decline the noun when it is preceded by a possessive adjective.

2. A possessive adjective may also precede a noun denoting family relationship in the plural, e.g. tim vllazën, time motra, but they are used so seldom in Albanian that we have preferred to eliminate them from our course.

1. A është im vllá gjithënji në Tiranë?  
Po, yt vllá është gjithënji në Tiranë.

Kush është gjithënji në Tiranë?  
Yt vllá është gjithënji në Tiranë.

Ku gjindet tash im vllá?  
Yt vllá është gjithënji në Tiranë.

A është kjo shtëpia e tim vllá?  
Po, kjo është shtëpia e tyt vllá.

Shtëpia e kujt është kjo?  
Kjo është shtëpia e tim vllá.

Cila është shtëpia e tim vllá?  
Kjo është shtëpia e tyt vllá.

A i shkrove tim vllá?  
Po, i shkrova tyt vllá.

Kush i shkroi tim vllá?  
Unë i shkrova tyt vllá.

A e pé tim vllá në Tiranë?  
Jo, s'e pashë tët vllá.

Kush s'e pá tim vllá në Tiranë?  
Unë s'e pashë tët vllá në Tiranë.

A ke marrë ndonji lajm prej tim vllá?  
Jo, s'kam marrë asnji lajm prej tyt vllá.

A është im át tue më pritë në stacion?  
Po, yt át është tue të pritë në stacion.

Kush është tue më pritë në stacion?  
Yt át është tue të pritë në stacion.

Kë është tue pritë në stacion im át?  
Yt át është tue të pritë tÿ në stacion.

Ku është tue më pritë im át?  
Yt át është tue të pritë në stacion.

A është ky punëtori i tim et?  
Po, ky është punëtori i tyt et.

Punëtori i kujt është ky?  
Ky është punëtori i tyt et.

Cili është punëtori i tim et?  
Ky është punëtori i tyt et.

A i shkrove tim et për punën e të hollavet?  
Po, i shkrova tyt et për punën e të hollavet.

Kujt i shkrove për punën e të hollavet?  
I shkrova tyt et për punën e të hollavet.

Për çka i shkrove tim et?  
I shkrova tyt et për punën e të hollavet.

A e pé tim át tue punue në kopsht?  
Po, e pashë tët át tue punue në kopsht.

Kush e pá tim át tue punue në kopsht?  
Unë e pashë tët át tue punue në kopsht.

Ku e pé tue punue tim át?  
E pashë tët át tue punue në kopsht.

A i ke marrë plaçkat prej tim et?  
Jo, s'i kam marrë ende plaçkat prej tyt et.

Kush s'i ka marrë ende plaçkat prej tim et?  
Unë s'i kam marrë ende plaçkat prej tyt et.

Çka s'ke marrë ende prej tim et?  
S'i kam marrë plaçkat ende prej tyt et.

2. A është ime motër gjithënji mësuese në Korçë?  
Po jot'motër është gjithënji mësuese në Korçë.

Kush është gjithënji mësuese në Korçë?  
Jot'motër është gjithënji mësuese në korçë.

Ç'punë ka ime motër në Korçë?  
Jot'motër është mësuese në Korçë.

Po burri i sime motër, a është nëpunës shteti gjithënjë?  
 Po, burri i sat'motër është nëpunës shteti gjithënjë.

Kush është nëpunës shteti gjithënjë?  
 Burri i sat'motër është nëpunës shteti gjithënjë.

Çfarë nëpunësi është burri i sime motër?  
 Burri i sat'motër është nëpunës shteti.

A i ka ardhë pasaporta sime motër?  
 Jo, sat'motër s'i ka ardhë pasaporta ende.

Kujt s'i ka ardhë pasaporta ende?  
 Sat'motër s'i ka ardhë pasaporta ende.

A e pë time motër tue shkue në shkollë?  
 Po, tët motër e pashë tue shkue në shkollë.

Kush e pë time motër tue shkue në shkollë?  
 Unë e pashë tët motër tue shkue në shkollë.

Ku e pë tue shkue time motër?  
 Tët motër e pashë tue shkue në shkollë.

A e bleve shtëpín prej sime motër?  
 Po, e bleva shtëpín prej sat'motër.

Kush e bleu shtëpín prej sime motër?  
 Unë e bleva shtëpín prej sat'motër.

Çka bleve prej sime motër?  
 Bleva shtëpín prej sat'motër.

3. A bërtas unë kur flas?  
 Po, ju bërtitni nganjherë kur flitni.

Kush bërtet nganjherë kur flet?  
 Unë bërtas nganjherë kur flas.

Po ai, a bërtet kur flet?  
 Po, edhe ai bërtet nganjherë kur flet.

LESSON 59

Me fjalë tjera, a bërtasim na të gjithë nganjherë kur flasim?

Po, me fjalë tjera ju të gjithë bërtitni nganjherë kur flitni.

Cilët bërtasin nganjherë kur flasin?  
Ata bërtasin nganjherë kur flasin.

A i bërtitni ju djalit kur bân shumë zhurmë?  
Po, unë i bërtas djalit kur bân shumë zhurmë.

Kush i bërtet djalit kur bân shumë zhurmë?  
Ju i bërtitni djalit kur bân shumë zhurmë.

Po ai, a i bërtet djalit kur bân shumë zhurmë?  
Po, edhe ai i bërtet djalit kur bân shumë zhurmë.

A u bërtasim na fëmijëvet kur nuk na ndigjojnë?  
Po, ju u bërtitni fëmijëvet kur nuk ju ndigjojnë.

Po ata, a u bërtasin fëmijëvet kur nuk u ndigjojnë?  
Po, edhe ata u bërtasin fëmijëvet kur nuk u ndigjojnë.

4. A ju la pa gjumë djali tue qá?  
Po, djali më la pa gjumë tue qá.

Kë la pa gjumë djali tue qá?  
Djali ju la ju pa gjumë tue qá.

A e latë djalit pa darkë mbasi s'kishte shkue në shkollë dje?  
Po, e lash djalit pa darkë mbasi s'kishte shkue në shkollë dje.

Kush e la djalit pa darkë mbasi s'kishte shkue në shkollë dje?  
Ai e la djalit pa darkë mbasi s'kishte shkue në shkollë dje.

A ju la ai pa drekë mbasi erdhi tamam në kohë të drekës?  
Po, ai më la pa drekë mbasi erdhi tamam në kohë të drekës.

Kush ju la pa drekë mbasi erdhi tamam në kohë të drekës?  
 Ai më la pa drekë mbasi erdhi tamam në kohë të drekës.

A ju la ai pa punë tue folë vazhdimisht?  
 Po, ai më la pa punë tue folë vazhdimisht.

Kush ju la pa punë tue folë shumë?  
 Ai më la pa punë tue folë shumë.

5. A jeni në gjendje me ecë mbasi ju dhemb kamba?  
 Jo, nuk jam në gjendje me ecë.

Kush nuk është në gjendje me ecë mbasi i dhemb kamba?  
 Ju nuk jeni në gjendje me ecë mbasi ju dhemb kamba.

Po ai, a është në gjendje me ecë mbasi i dhemb kamba?  
 Jo, as ai s'është në gjendje me ecë mbasi i dhemb kamba.

A jeni në gjendje me më dhënë 1000 lekë hua?  
 Jo, më vjen keq; s'jam në gjendje.

Kush nuk është në gjendje me ju dhënë 1000 lekë hua?  
 Ju nuk jeni në gjendje me më dhënë 1000 lekë hua.

A është ai në gjendje aq të mirë sa me e blé shtëpin me të holla në dorë?  
 Jo, ai s'është në gjendje aq të mirë sa me e blé shtëpin me të holla në dorë.

Kush nuk është në gjendje me e blé shtëpin me të holla në dorë?  
 Unë nuk jam në gjendje me e blé shtëpin me të holla në dorë.

6. A e rrueni ju shokun që është në spital?  
 Jo. E rruen infermieri.

Kush e rruen shokun që është në spital?  
Infermieri e rruen shokun që është në spital.

A rruheni ju çdo ditë?  
Po, unë rruhem çdo ditë.

Kush rruhet çdo ditë?  
Ju rruheni çdo ditë?

Po ai, a rruhet çdo ditë?  
Po, edhe ai rruhet çdo ditë.

7. A i rrifni fëmijët ndonjiherë kur nuk ju ndigjojnë?  
Po, unë i rraf fëmijët nganjiherë kur nuk më ndigjojnë.

Kush i rref fëmijët nganjiherë kur nuk i ndigjojnë?  
Ju i rrifni fëmijët nganjiherë kur nuk ju ndigjojnë.

Po ai, a i rref fëmijët nganjiherë kur nuk e ndigjojnë?  
Po, edhe ai i rref fëmijët nganjiherë kur nuk e ndigjojnë.

A e tepron ai kur bân ndonji shaka?  
Po, ai e tepron kur bân ndonji shaka.

Kush e tepron kur bân ndonji shaka?  
Ai e tepron kur bân ndonji shaka.

A e tepron ai kur kallxon ndonji gjâ mbi jetën e tij?  
Po, ai e tepron kur kallxon ndonji gjâ mbi jetën e tij.

Kush e tepron kur kallxon ndonji gjâ mbi jetën e tij?  
Ai e tepron kur kallxon ndonji gjâ mbi jetën e tij.

A ju tepron ndonji herë gjella që ju apin në mensë?  
Po, më tepron nganjiherë.

Kujt i tepron nganjiherë gjella që i apin në mensë?  
Jû ju tepron nganjiherë gjella që ju apin në mensë.

LESSON 59

Po atij, a i tepron ndonjiherë gjella që i apin në mensë?

Jo, atij s'i tepron kurr.

A ju tepron ndonji lek në fund të muejit?

Jo, nuk më tepron asnji lek në fund të muejit.

Kujt nuk i tepron asnji lek në fund të muejit?

Jú nuk ju tepron asnji lek në fund të muejit.

Po atij, a i tepron ndonji lek në fund të muejit?

Po, atij i teprojnë nja 50-60 lekë.

Kujt i teprojnë nja 50-60 lekë në fund të muejit?

Atij i teprojnë nja 50-60 lekë në fund të muejit.

A është e nevojshme që të jem edhe unë aty?

Po, është e nevojshme që të jeni edhe ju aty.

A është e nevojshme që të bëj lutje për të kërkue leje?

Po, është e nevojshme që të bëni lutje për të kërkue leje.

Im bîr, Aliu, kur ishte 8 vjeç, pati çfaqë dëshirën shumë herë se donte me u-bâ berbër. "Babë," më thonte, "kur të hap rrojtoeren time do të vîjsh ke unë me u-qethë e me u-rrue." Kurrë nuk e besojshem se do të kishem pasë ngatrresa me këtë dëshirë të tijën. Qe çka ngjau:

Nji ditë, në kohë të vapës, kur unë dhe gjithë njerzit e shtëpis po flëjshim, shkoi në banjë, hapi raftin dhe mori veglat e rrojes: briskun sapunin, gërshanën dhe nji krahën. Pa bâ zhurmë u-ul poshtë dhe shkoi në shtallë ku mbajshim kafshët dhe atje filloi mjeshtërinë e tij si berbër: kapi nji nga nji pulat, patat e rosat dhe u preu krahët me gërshanë dhe mandej shkoi ke lopët dhe u preu bishtat. Në fund shkoi në thark dhe atje deshi me rrue derrat. Derrat filluen me bërtitë kaq fort sa zgjuen gjithë lagjen. Zbrita poshtë, kur çka me pá! Po i rridhte gjak nga duert: kishte pré gishtat e natyrisht, edhe derrat.

Mbaj mend si sot se u-zemrova shumë, e kapa për veshi dhe mbasi e çova nalt në dhomën e tij, ku e mbylla gjithë mbasdreken, e rrafa mirë e mirë. Kjo ka qenë e para dhe e fundit herë që kam rrafë tim bîr.

## QUESTIONS-PYETJE

1. Kur pati çfaqë dëshirën Aliu se donte me u-bâ berbër?
2. Sa vjeç ishte Aliu kur pati çfaqë dëshirën se donte me u-bâ berbër?
3. Kujt i thonte "Babë kur të hap rrojtoren time do të vîjsh me u-qethë e me u-rrue ke unë"?
4. Çka i thonte Aliu babës?
5. Kush nuk e besonte kurr se do të kishte pasë ngatrresa me këtë dëshirë të tijën?
6. Kush shkoi në banjë një ditë, në kohë të vapës?
7. Çka bëri Aliu një ditë, në kohë të vapës?
8. Kur po flëjshin njerzit e shtëpisë?
9. Kush hapi raftin e mori veglat e rrojes?
10. Çka bëri Aliu?
11. Kush mori briskun, sapunin, gërshanën e një krahën?
12. Kush u-ul poshtë pa bâ zhurmë e shkoi në shtallë?
13. Qysh u-ul poshtë Aliu e shkoi në shtallë?
14. Ku i mbante kafshët familja e Aliut?
15. Kush filloi atje mjeshtrimin e tij si berbër?
16. Çka bëri Aliu në shtallë?
17. Kush kapi, një nga një, pulat, patat e rosat dhe u preu krahët?
18. Cilëve shpend u preu krahët Aliu?
19. Çka u preu Aliu pulavet, patavet e rosavet?

LESSON 59

20. Ku shkoi Aliu mâ në fund e aty deshi me rrue derrat?
21. Çka deshi të bânte Aliu në thark?
22. Cilët filluen me bërtitë kaq fort sa zgjuen gjithë lagjen?
23. Çka filluen të bâjnë derrat?
24. Kush zbriti poshtë?
25. Kujt po i rridhte gjak nga duert?
26. Kush kishte pré dy gishta e natyrisht edhe derrat?
27. Kush u-zemrue shumë dhe e kapi Aliun për veshi?
28. Çka bâni i ati i Aliut mbasi u-zemrue shumë?
29. Kë çoi i ati nalt në dhomën e tij?
30. Kush e rrafi Aliun mirë e mirë?
31. Qysh e rrafi Aliun i ati?
32. Kush e mbylli Aliun gjithë mbasdreken në dhomën e tij?
33. Ku e mbylli i ati Aliun gjithë mbasdreken?

- A. Use the possessive adjectives preceding the underlined nouns. Nouns djali, vajza and grueja have to be replaced by different nouns with the same meanings.
1. Djali im është tue studjue mjeksi.
  2. Vllai yt dhe motra jote janë në shtëpin time.
  3. Vajza ime do të shkojë në shtëpi të motrës sime.
  4. S'kam marrë letër prej grues sime.
  5. Mbramë pashë vllan tând.
- B. Përkëtheni anglisht:
6. Atij i pëlqen me pi, por kurrë nuk e tepron.
  7. Disa njerëz kur flasin duket sikur bërtasin.
  8. Në Shqipni, zyrat e dyqanet mbyllen gjatë orëvet të vapës.
  9. Unë u bërtas fëmijëvet.
  10. S'kam dëshirë për asgjâ.

PJESA E SHTATË  
FJALORI

LESSON 59  
PART VII  
VOCABULARY

me bërtitë (unë bërtas)	(v.)	to shout, to scream, to holler, to yell; to scold
bisht, -i bishta, -t	(m.)	tail
me çfaqë (unë çfaq)	(v.)	to express, to show, to display, to de- clare; to play, per- form
me u-çuditë (unë çuditem)	(v.)	to be surprised, to be amazed, to be astonished
dëshirë, -a dëshira, -t	(f.)	wish, desire
gërshanë, -a gërshanë, -t	(f.)-	scissors
gisht, -i gishta, -t	(m.)	finger, toe
gjendje, -a	(f.)	state, condition, situation
hatá, hataja	(f.)	something bad, some- thing awful
me kapë (unë kap)	(v.)	to catch, to hold, to grab, to seize, to take
e keqe, e keqja të këqija, -t	(f.)	wrong, bad, evil, the bad part of ....
lagje, lagja lagje, -t	(f.)	city district, quarter, neighbor- hood

LESSON 59

me lëvizë (unë lëviz)	(v.)	to move
me mjekue (unë mjekoj)	(v.)	to treat (med.)
nervoz, -e	(adj.)	nervous
i, të nevojshëm e, të nevojshme	(adj. m.&f.)	necessary, needed
ngatrrësë, -a ngatrresa, -t	(f.)	trouble, tangle, intrigue, dis- turbance
me rrafë (unë rraf)	(v.)	to beat, to thresh, to thrash, to spank
rroje, rroja	(f.)	shaving (as noun)
me rrue (unë rrue,)	(v.)	to shave
shejtan, -i shejtana, -t	(m.)	devil
shtallë, -a shtalla, -t	(f.)	stable, stall, barn
me teprue (më tepron)	(v.)	to be left over, to be surplus
me e teprue (unë e teproj)	(v.)	to exaggerate, to overdo
thark, -u tharqe, -t	(m.)	pigpen, sty
vapë, -a	(f.)	heat wave, very hot weather, siesta time heat
me zemrue (unë zemroj)	(v.)	to anger, to irritate

LESSON 59

zjarmfikës, -i  
zjarmfikës, -it

(m.) fireman

zhurmë, -a  
zhurma, -t

(f.) noise, din

Shenime:

çuditësh sikur t'a  
dijsh

you'd be surprised if you  
knew

kështu e kanë fëmijët

that's how children are

me mbajtë në vend

to keep in its place

mirë dita!

good day!

punë e madhe!

big deal! who cares!  
so what!; beautiful, nice

më ka lënë pa gjumë

he didn't let me sleep

me qenë nervoz  
(unë jam nervoz)

to be nervous

PJESA E PARË  
 USHTRIMË GRAMATIKORE PARAPRAKE-GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1.

a. A e keni marrë orarin e mësimit?  
 Po, unë e kam marrë orarin e mësimit.

Çka keni marrë ju?  
 Unë e kam marrë orarin e mësimit.

Kush e ka marrë orarin e mësimit?  
 Unë e kam marrë orarin e mësimit.

A ka edhe shoku juej një orar mësimi?  
 Po, edhe shoku im ka një orar mësimi.

Edhe kush ka një orar mësimi?  
 Edhe shoku im ka një orar mësimi.

Çka ka shoku juej?  
 Shoku im ka një orar mësimi.

A keni të gjithë nga një orar mësimi?  
 Po, të gjithë kemi nga një orar mësimi.

A keni të gjithë edhe nga një libër leximi?  
 Po, na të gjithë kemi edhe nga një libër leximi.

Cilët kanë nga një libër leximi?  
 Na të gjithë kemi nga një libër leximi.

A ju pëlqen ju mishi i viçit?  
 Po, mua më pëlqen mishi i viçit.

Çka i pëlqen atij?  
 Atij i pëlqen mishi i viçit.

A keni hangër ju dje mish viçi?  
 Po, unë kam hangër dje mish viçi.

Çka ka hangër shoku juej dje?  
 Shoku im ka hangër dje mish viçi.

A keni blé edhe për sot mish viçi?  
 Jo, për sot nuk kam blé mish viçi.

LESSON 60

A keni blé mish derri për sot?  
Po, për sot kam blé mish derri.

b. A është sot ditë pushimi?  
Jo, sot nuk është ditë pushimi.

A është e shtundja ditë pushimi n'Amerikë?  
Po, n'Amerikë e shtundja është ditë pushimi.

A është e merkurrja ditë pazari në Shkodër?  
Po, e merkurrja është ditë pazari në Shkodër.

Në ç'vend të Shqipnis është e merkurrja ditë pazari?  
Në Shkodër është e merkurrja ditë pazari.

A është sot ditë dimni?  
Jo, sot nuk është ditë dimni.

A është sot ditë pranvere?  
Po, sot është ditë pranvere.

A është sot ditë vere?  
Jo, sot nuk është ditë vere.

A është sot ditë vjeshte?  
Jo, sot nuk është ditë vjeshte.

Çfarë dite është sot?  
Jo, kët ndërtesë nuk e ngrofin me kalorifer.

Cilën ndërtesë nuk ngrofin me kalorifer?  
Kët ndërtesë nuk e ngrofin me kalorifer.

Po shtëpija e tij, a ka kalorifer?  
Po, shtëpija e tij ka kalorifer.

Shtëpija e kujt ka kalorifer?  
Shtëpija e tij ka kalorifer.

A keni mysafirë shpesh?  
Po, unë kam mysafirë shpesh.

Kush ka mysafirë shpesh?  
Unë kam mysafirë shpesh.

Çka keni shpesh?  
Unë kam mysafirë shpesh.

A ju pëlqejnë mja shumë shtëpit me oborr apor  
apartamentet?  
Mue më pëlqejnë mja shumë shtëpit me oborr.

LESSON 61

Kujt i pëlqejnë më shumë shtëpit me oborr?  
Mue më pëlqejnë më shumë shtëpit me oborr.

Cilat shtëpi ju pëlqejnë më shumë se apartamentet?  
Mue më pëlqejnë më shumë shtëpit me oborr se apartamentet.

A ka pothuej çdo sallon sofa, kolltukë e së paku  
nji tryezë?  
Po, pothuej çdo sallon ka sofa, kolltukë e së  
paku nji tryezë.

Çka ka pothuej çdo sallon?  
Pothuej çdo sallon ka sofa, kolltukë e së paku  
nji tryezë.

Çfarë mobiljesh ka pothuej çdo sallon?  
Pothuej çdo sallon ka sofa, kolltukë e së paku  
nji tryezë.

A është e lehtë me nxjerrë ujë prej nji pusi?  
Po, është e lehtë me nxjerrë ujë prej nji pusi.

Çka është e lehtë me bërë?  
Asht e lehtë me nxjerrë ujë prej nji pusi.

Prej nga është e lehtë me nxjerrë ujë?  
Asht e lehtë me nxjerrë ujë prej nji pusi.

A ka ujësjellës Monterej?  
Po, Monterej ka ujësjellës.

Çka ka Monterej?  
Monterej ka ujësjellës.

Cili qytet ka ujësjellës?  
Monterej ka ujësjellës.

A mbuloheni me shumë batanije në dimën?  
Jo, unë nuk mbulohem me shumë batanije në dimën.

Kush nuk mbulohet me shumë batanije në dimën?  
Unë nuk mbulohem me shumë batanije në dimën.

LESSON 61


Me sa batanije mbuloheni në dimën?  
Në dimën unë mbulohem me dy batanije.

Me çka mbuloheni?  
Unë mbulohem me batanije.

A ka shtëpija jote suvâ përjashta?  
Po, shtëpija ime ka suvâ përjashta.

Çka ka shtëpija jote përjashta?  
Shtëpija ime ka suvâ përjashta.

Shtëpija e kujt ka suvâ përjashta?  
Shtëpija ime ka suvâ përjashta.



Shtëpija e vllazënve Frashëri, tash muzé

Në përgjithësi, banesat në Shqipëri nuk janë shumë të ndryshme nga ato në Shtetet e Bashkueme t'Amerikës. Shtëpitë në vendin tonë u përgjajnë shumë shtëpivët të vjetra që kanë ndërtue meksikanët këtu në Monterej.

Asht e zakonshme që djelmët të rrijnë me banue me prindët edhe mbasi të martohen. Në përgjithësi pra, familja shqiptare është më e madhe se familja amerikane dhe natyrisht, edhe banesat janë më të mëdhaja. Nji shtëpi me dhjetë dhoma fjetje nuk është nji gjë e rrallë. Kjo është arsyeja që shtëpitë janë zakonisht dykatshe dhe, si thamë, me shumë dhoma fjetje. Ndërtesat me tri, katër ose me pesë kate janë ndërtesa qeveritare, hotele ose janë ndërtesa me apartamente.

Në zonat malore të Shqipërisë shtëpitë ndërtohen me gurë sepse gurët gjinden në vend; gurët dhe rana merren pa pagesë. Në zonat tjera të Shqipërisë shtëpitë ndërtohen zakonisht me tulla dhe, por jo shumë shpesh, me qerpiç. Dërrasat përdoren për të ndërtue pjesët e mbrendshme të shtëpisë, si p.sh. dyshtemenë, tavanin,

shkallët etj. Shpeshherë, në të njëjtin oborr ndërtojnë edhe një shtëpi të vogël pa dysheme që quhet "jereví;" kjo shërben për punë të ndryshme të shtëpis: për të lá plaçkat, për të përgatitë venën e rakín ase për të ruejtë gjâna ushqimi. Kuzhina, dhoma e bukës, që âsht një ndër dhomat mâ të rëndësishme të shtëpis, dhe dhoma e pritjes ndodhen në katin e parë; dhomat e fjetjes dhe nevojtorja gjinden në katin e dytë. Shtëpit e vjetra i kanë nevojtoret jashtë, diku në kopsht, larg shtëpis.

Nëpër vende ku dimni nuk âsht shumë i ftofët, njerzit përdorin mangall për të ngrofë dhomën ku rrijnë të shumtën e kohës; nëpër vende të ftofta përdorin stufë ase oxhak. Nuk ka shtëpi pa oxhak nëpër malet e vendit tonë.

#### QUESTIONS-PYETJE

1. A janë shumë të ndryshme nga ato të Shteteve të Bashkueme banesat në Shqipni?
2. Në cilin vend nuk janë të ndryshme banesat nga ato të Shteteve të Bashkueme t'Amerikës?
3. Cilave shtëpi u përgjajnë shtëpit e Shqipnis?
4. Kush i ka ndërtue shumë prej shtëpive të vjetra të Monterejt?
5. Ç'stil kanë shumë prej shtëpive të vjetra të Monterejt?

LESSON 61

6. Çfarë shtëpish - këtu në Monterej - janë të stilit spanjoll?
7. Kur martohen djelmët në Shqipëri, zakonisht, a rrijnë me prindët apo ndahen prej tyre?
8. Cila familje në përgjithësi, është më e madhe se familja amerikane?
9. Pse është familja shqiptare, në përgjithësi, më e madhe se familja amerikane?
10. Për këtë arsye, a janë edhe banesat në Shqipëri më të mëdhaja se këtu në Amerikë?
11. Zakonisht, ku janë banesat më të mëdhaja se këtu në Amerikë?
12. Pse janë banesat në Shqipëri më të mëdhaja se këtu në Amerikë?
13. Në cilin vend nuk është gjë e rrallë një shtëpi me 10 dhoma fjetje?
14. Një shtëpi me sa dhoma fjetje nuk është një gjë e rrallë në Shqipëri?
15. Sa katesh janë shtëpitë në Shqipëri, zakonisht?
16. Cilat ndërtesa janë dykatshe në Shqipëri?
17. Po ndërtesat qeveritare, hotelet dhe shtëpitë me apartamente, sa katesh janë?
18. Cilat ndërtesa janë zakonisht me tri, katër ose me pesë kate?
19. Me çfarë materiali ndërtohen shtëpitë në zonat malore të Shqipërisë?
20. Në cilat zona të Shqipërisë ndërtohen shtëpitë me gurë?
21. Pse ndërtohen shtëpitë me gurë në zonat malore?

LESSON 61

22. Ç'material marrin pa pare ata që ndërtojnë shtëpi në zona malore?
23. Zakonisht, me ç'lloj materiali i ndërtojnë shtëpit në zonat tjera të Shqipërisë?
24. Në cilat zona të Shqipërisë i ndërtojnë shtëpit me tulla e nganjherë edhe me qerpiç?
25. Përveç shtëpivet me tulla, çfarë shtëpish tjera ndërtojnë sidomos në Tiranë?
26. Çka përdorin për të ndërtue pjesët e mbrendëshme të shtëpisë?
27. Si quhen pjesët e shtëpisë, të cilat ndërtohen me dërrasa?
28. Si quhet shtëpija e vogël që ndërtojnë shpeshherë në oborrin e një shtëpije?
29. Për çka shërben kjo shtëpi e vogël ase jerevi?
30. Në cilin kat të shtëpisë ndodhen kuzhina, dhoma e bukës dhe dhoma e pritjes?
31. Në cilin kat gjinden dhomat e fjetjes dhe nevojtorja?
32. Ku i kanë nevojtoret disa prej shtëpivet të vjetra?
33. Cilat shtëpi i kanë nevojtoret jashtë?
34. Ç'përdorin Shqiptarët për të ngroftë dhomën ku rrijnë ndër ato vende ku dimni nuk është shumë i ftoftë?
35. Po në vende të ftofta, ç'përdorin për të ngroftë dhomën ase shtëpinë?
36. Në cilat pjesë të Shqipërisë të gjitha shtëpit janë me oxhak?

PJESA E GJASHTË  
DETYRË SHTËPIJE

LESSON 61  
PART VI  
HOMEWORK

- A. In the following sentences the verb is in the active voice. Rewrite the sentences, using the passive voice.

Example:

Active: Në Shqipni dyshtemenë e lajnë me ujë e sapun.

Passive: Në Shqipni dyshtemeja lahet me ujë e sapun.

1. Kët shtëpi e kanë ndërtue vetëm dy punëtorë.
2. Venën e rakin i bëjnë në bodrum.
3. Dërrasat i përdorin për të bër mobilje.
4. Kapterin e dërguen në spital.

B. Translate:

5. The tallest building in America is in Chicago and is 110 stories high.
6. In the villages there is no running water (water supply); people get the water from the well or from a spring, if any.
7. I cannot go out right now because I have company.
8. In Albania they don't usually heat the bedrooms.

PJESA E SHITATË  
FJALORI

LESSON 61  
PART VII  
VOCABULARY

apartament, -i apartamente, -t	(m.)	apartment
banesë, -a banesa, -t	(f.)	dwelling, residence
barakë, -a baraka, -t	(f.)	hut, shed
blok, -u bloqe, -t	(m.)	block
çati, -ja çatí, -t	(f.)	roof
dërrasë, -a dërrasa, -t	(f.)	board, plank
dykatshe	(adj. f.)	two-story house or building
dysheme, -ja dysheme, -t	(f.)	floor
gúr, -i gurë, -t	(m.)	stone, rock
kalorifer, -i kaloriferë, -t	(m.)	heater, radiator
mangall, -i mangaj, -t	(m.)	brazier
material, -i materiale, -t	(m.)	material
me u-mbledhë (unë mblidhem)	(v.)	to get together, to gather, to rally, to assemble, to con- vene; to double up (from pain, fear, etc.)

LESSON 61

me mbulue (unë mbuloj)	(v.)	to cover
mysafir, -i mysafirë, -t	(m.)	guest
me ndërtue (unë ndërtoj)	(v.)	to build
me u-ndërtue (ndërtohet)	(v.)	to be built
me ngroftë (unë ngroft)	(v.)	to heat, to warm
oborr, -i oborre, -t	(m.)	yard, court
oxhak, -u oxhakë, -t	(m.)	fireplace, chimney, smokestack
me u-përdorë (unë përdorem)	(v.)	to be used
përdhës, -e	(adj. m.&f.)	ground (floor)
me përgjã (unë përgjãj)	(v.)	to resemble
përmbi	(prep)	on, upon, above, about
pus, -i puse, -t	(m.)	well (water, oil)
i, të rahatshëm e, të rahatshme	(adj. m.&f.)	comfortable
sallon, -i sallone, -t	(m.)	large living room

LESSON 61

shkallë, -a shkallë, -t	(f.)	stair, stairway, step, flight of steps, ladder, ex- tent, degree, rank, level, standard
suvá, -ja	(f.)	stucco
tavan, -i tavane, -t	(m.)	ceiling
tjegull, -a tjegulla, -t	(f.)	tile
tullë, -a tulla, -t	(f.)	brick
ujësjellës, -i ujësjellës, -it	(m.)	water main, water supply

## PJESA E PARË

## ËSHTRIMË GRAMATIKORE PARAPRAKË-GRAMMAR PERCEPTION DRILL

- a. A ke marrë ti dy libra prej meje?  
Po, unë kam marrë dy libra prej teje.

Çka kam marrë unë prej jush?  
Ju keni marrë dy libra prej nesh.

Çka kam marrë unë prej tij?  
Ju keni marrë dy libra prej tij.

Çka kam marrë unë prej atij?  
Ju keni marrë dy libra prej atij.

Çka kam marrë unë prej saj?  
Ju keni marrë dy libra prej saj.

Çka kam marrë unë prej asaj?  
Ju keni marrë dy libra prej asaj.

Çka kam marrë unë prej tyne?  
Ju keni marrë dy libra prej tyne.

Çka kam marrë unë prej atyne?  
Ju keni marrë dy libra prej atyne.

Kush ka marrë dy libra prej meje? (teje, tij etj.)  
Unë kam marrë dy libra prej teje. (tij etj.)

- b. A ulet ai afër teje?  
Po, ai ulet afër meje.

Cili prej jush ulet afër atij?  
Z. .... ulet afër atij.

Kush ulet afër tij?  
Z. .... ulet afër tij.

A uleni ju afër nesh?  
Po, na ulemi afër jush.

Kush ulet afër saj?  
Ai ulet afër saj.

LESSON 62

A ulen ata afër asaj?  
Po, ata ulen afër asaj.

A ju pëlqen edhe ju me u-ulë afër asaj?  
Po, edhe mue më pëlqen me u-ulë afër asaj.

A ulem unë nganjihërë afër atyne?  
Po, ju uleni nganjihërë afër atyne.

Kush ulet nganjihërë afër tyne?  
Ju uleni nganjihërë afër tyne.

c. A ka një karrigë pranë teje?  
Po, pranë meje ka një karrigë.

A ulet mësuesi pranë jush?  
Jo, mësuesi nuk ulet pranë nesh.

A jam tash unë pranë tij?  
Jo, ju nuk jeni tash pranë tij.

A jeni ju pranë atij?  
Jo, unë nuk jam pranë atij.

Çka ka pranë asaj pikturë?  
Pranë asaj pikturë ka një gozhdë.

A ulet mësuesja gjithëmonë pranë tyne?  
Po, mësuesja ulet gjithëmonë pranë tyne.

d. A je ti tash larg meje?  
Po, unë jam tash larg teje.

A jam unë tash larg jush?  
Po, ju jeni tash larg nesh.

Kush është larg jush?  
Ju jeni larg nesh.

A është edhe ai larg jush?  
Po, edhe ai është larg meje.

Po ajo, a është larg jush?  
Po, edhe ajo është larg nesh.

A jeni ju larg asaj?  
Po, unë jam larg asaj.

Cilët janë larg saj?  
Na të gjithë jemi larg saj.

Pse rri ajo larg atij?  
Nuk e di, pse rri ajo larg atij.

A vjen ti në klasë para meje?  
Po, unë vij në klasë para teje.

A vjen ti në klasë para tij?  
Po, unë vij në klasë para tij.

A vjen ti në klasë para nesh?  
Po, unë vij në klasë para jush.

A vjen ti në klasë para tyre?  
Po, unë vij në klasë para tyre.

2. i cili

Statements: Djali im është mjek.  
Djali im ka dy fëmijë.

Relative Pronoun: Djali im, i cili është mjek,  
ka dy fëmijë.

Statements: Mësuesi është i sëmundë.  
Unë shkova dje në kinema me mësuesin.

Relative Pronoun: Mësuesi, me të cilin shkova dje  
në kinema, është i sëmundë.

Statements: Shoku erdhi sot në mëngjes.  
Unë kam marrë dje dy libra prej shokut.

Relative Pronoun: Shoku, prej të cilit kam marrë  
dje dy libra, erdhi sot në mëngjes.

Statements: Majori nuk vjen sot.  
Majorit i thash me folë me ju.

Relative Pronoun: Majori, të cilit i thash me folë  
me ju, nuk vjen sot.

Statements: Ky ujë është i nxehët.  
Na jemi tue pë prej këtij uji.

Relative Pronoun: Ky ujë, prej të cilit jemi tue  
pë, është i nxehët.

të cilët

Statements: Djetmt e mij janë mjekë.  
Djetmt e mij kanë nga dy fëmijë.

Relative Pronoun: Djetmt e mij, të cilët kanë nga  
dy fëmijë, janë mjekë.

Statements: Dy prej mësuesvet janë të sëmundë.  
Unë shkova në kinema dhe me dy mësues.

Relative Pronoun: Dy prej mësuesvet, me të cilët  
shkova dhe në kinema, janë të  
sëmundë.

Statements: Shokët erdhën sot në mëngjes.  
Unë kam marrë dhe dy letra prej shokëve.

Relative Pronoun: Shokët, prej të cilëve kam marrë  
dhe dy letra, erdhën sot në  
mëngjes.

Statements: Oficerat nuk vijnë sot.  
Unë u thash oficeravet me folë me ju.

Relative Pronoun: Oficerat, të cilëve u thash me  
folë me ju, nuk vijnë sot.

Statements: Ata dy vllazën janë të pasun.  
Kjo shtëpi është e atyne dy vllazënve.

Relative Pronoun: Ata dy vllazën, e të cilëve është  
kjo shtëpi, janë të pasun.

e cila

Statements: Vajza ime është e martueme.  
Vajza ime nuk flet shqip.

LESSON 62

Relative Pronoun: Vajza ime, e cila nuk flet shqip,  
është e martueme.

Statements: Dhoma ime është e vogël.  
Ngjyra e dhomës sime më pëlqen shumë.

Relative Pronoun: Dhoma ime, ngjyra e së cilës më  
pëlqen shumë, është e vogël.

Statements: Motra jonë është shumë e vorfën.  
Motrës sonë i pëlqen kjo shtëpi.

Relative Pronoun: Motra jonë, së cilës i pëlqen  
kjo shtëpi, është shumë e vorfën.

Statements: Halla ime jeton në Durrës.  
Unë marr peshqeshe shpesh prej hallës.

Relative Pronoun: Halla ime, prej së cilës marr  
peshqeshe shpesh, jeton në Durrës.

Statements: Kjo pëndë është shumë e kushtueshme.  
Me këtë pëndë unë shkruaj vetëm letra.

Relative Pronoun: Kjo pëndë, me të cilën shkruaj  
vetëm letra, është e kushtueshme.

të cilat

Statements: Vajzat e mija janë të martueme.  
Vajzat e mija nuk flasin shqip.

Relative Pronoun: Vajzat e mija, të cilat nuk flasin  
shqip, janë të martueme.

Statements: Dhomat e mija janë të vogla.  
Dritoret e dhomave të mija më pëlqejnë  
shumë.

Relative Pronoun: Dhomat e mija, dritoret e të  
cilave më pëlqejnë shumë, janë  
të vogla.

LESSON 62

Statements: Vajzat nuk vijnë sot.  
Unë u thash vajzavet me folë me jû.

Relative Pronoun: Vajzat, të cilave u thash me  
folë me jû, nuk vijnë sot.

3.

a. A keni dy vllazën ju?  
Po, unë kam dy vllazën.

A është njëni ushtár?  
Po, njëni është ushtár.

A është tjetri nëpunës?  
Po, tjetri është nëpunës.

Çë punë bân njëni dhe çë punë bân tjetri?  
Njëni është ushtár dhe tjetri është nëpunës.

A është ky libër i njënit vllá dhe ai i tjetrit?  
Po, ky libër është i njënit vllá dhe ai i tjetrit.

A është ky automobil i njënit dhe ai i tjetrit?  
Po, ky automobil është i njënit dhe ai i tjetrit.

A janë këta lapsa të njënit dhe ata të tjetrit?  
Po, këta lapsa janë të njënit dhe ata të tjetrit.

Të kujt janë këta lapsa?  
Këta lapsa janë të njënit.

Të kujt janë ata lapsa?  
Ata lapsa janë të tjetrit.

A i dërguet letër për Krishtlindje njënit vllá?  
Po, unë i dërgova letër për Krishtlindje njënit  
vllá.

Kujt i dërguet letër për Krishtlindje?  
Unë i dërgova letër për Krishtlindje njënit vllá.

A i a dhatë peshqeshin njënit vllá në shtëpi?  
Po, unë i a dhash peshqeshin njënit vllá në  
shtëpi.

A shkruet në teatër me njânin vllâ?  
Po, unë shkova në teatër me njânin vllâ.

A u-këthyet me njânin vllâ vonë në shtëpi?  
Po, unë u-këtheva vonë në shtëpi me njânin vllâ.

Me kë u-këtheve vonë në shtëpi?  
Unë u-këtheva vonë në shtëpi me njânin vllâ.

A more peshqesh vetëm prej njânit vllâ për Krishtlindje?  
Po, unë mora peshqesh vetëm prej njânit vllâ për Krishtlindje.

Vetëm prej cilit vllâ more peshqesh për Krishtlindje?  
Unë mora peshqesh vetëm prej njânit vllâ për Krishtlindje.

Çka more vetëm prej njânit?  
Unë mora peshqesh vetëm prej njânit.

Prej kujt more peshqesh?  
Unë mora peshqesh vetëm prej njânit.

b. A keni dy motra ju?  
Po, unë kam dy motra.

A është njâna nëpunëse dhe tjetra nxânëse?  
Po, njâna është nëpunëse dhe tjetra nxânëse.

Çë punë bân njâna dhe çë punë bân tjetra?  
Njâna është nëpunëse dhe tjetra është nxânëse.

A është ajo revistë e njânes motër dhe tjetra e tjetrës?  
Po, ajo revistë është e njânes motër dhe tjetra e tjetrës.

E cilës është ajo revistë?  
Ajo revistë është e njânes.

A janë të njânes motër ato gazeta?  
Po, ato gazeta janë të njânes motër.

Të cilës janë ato gazeta?  
Ato gazeta janë të njëlës motër.

A i dërguet letër për ditën e emnit njëlës motër?  
Po, unë i dërgova letër për ditën e emnit njëlës motër.

Kujt i dërgove letër për ditën e emnit?  
Unë i dërgova letër për ditën e emnit njëlës motër.

A i bletë njëlës vajzë një palë këpucë dhe tjetrës një palë rrobe?  
Po, unë i bleva njëlës vajzë një palë këpucë dhe tjetrës një palë rrobe.

Cilës i bleve një palë këpucë dhe cilës një palë rrobe?  
Njëlës i bleva një palë këpucë dhe tjetrës një palë rrobe.

A shkuet me njëlën motër në kishë për Krishtlindje?  
Po, për Krishtlindje unë shkova në kishë me njëlën motër.

Me kë shkuet në kishë për Krishtlindje?  
Unë shkova në kishë për Krishtlindje me njëlën motër.

A shkoi vllai juej me tjetrën motër në kishë?  
Po, vllai im shkoi me tjetrën motër në kishë.

Kush shkoi me njëlën dhe kush me tjetrën?  
Unë shkova me njëlën dhe ai shkoi me tjetrën.

A e bletë ju kapelën për njëlën dhe ai çantën për tjetrën?  
Po, unë e bleva kapelën për njëlën dhe ai çantën për tjetrën.

A more ti peshqesh vetëm prej njëlës, apo edhe prej tjetrës?  
Unë mora peshqesh edhe prej njëlës edhe prej tjetrës.


Në polici

1. Ulu këtu pranë meje! Të kemi thirrë me të marrë në pyetje rreth ngjarjes së djeshme.
2. Rreth vrasjes që u-bâ para portës së shtëpis sime?
3. Po. Jam i ngarkuem me mbajtë procesverbalin.
4. Do të rrëfej ato që dij e që kam pá.
5. A e ke njoftë mâ parë të pandehunin?
6. S'kam pasë miqësi me të, por i a kam ndigjue emnin shpeshherë dhe e kam pá në klubin e punëtorëvet.
7. Për çfarë njeriu e di?
8. Për njeri të lig. Ka qenë disa herë në burg.
9. Pse e kanë futë në burg?
10. Për zihje, për grindje, i pëlqejnë shumë grindjet, për mbajtje arme pa leje, për prishjen e qetësis publike.
11. A je i sigurtë se nuk je tue i shpifë këto gjâna?
12. Pse, a dyshoni? Shikoni në dosjen e tij që ka policija. Ju vetë e keni arrestue.
13. Mos u-zemro e përgjigju pyetjevet! Ku ishte ti kur i pandehuni shtiu?
14. Mbas portës; po përgjojsnem kur po ziheshin me fjalë.
15. Për çka po ziheshin?
16. I vrami i kërkonte vrasësit që t'i paguente borxhin; për këtë po ziheshin.
17. S'është arsye e fortë kjo me u-vrâ.
18. Ju thash se po ziheshin me fjalë dhe se i pandehuni ka qenë gjithëmonë njeri i keq.

LESSON 62

19. Ç'bâne ti kur shtiu ai?
20. Hapa portën, dola jashtë dhe pashë ....
21. Mirë, mirë! Kaq mjafton. Të tjerat thueja  
gjkatsit në gjyq kur të të thërrasin si dëshmi-  
târ. Nënshkruej këtu!
22. A bân t'a lexoj mâ parë?
23. Mirë, por mos humb kohë!

# LESSON 62



At the Police Department

1. Sit beside me! We have called you to tell us (about) what happened yesterday.
2. About the murder that was committed in front of my gate?
3. Yes, I am in charge of writing a statement about it.
4. I'll tell you what I know and what I saw.
5. Have you known the defendant before?
6. We were not friends, but I have heard his name often and I have seen him at the Workers' Club.
7. Do you know what kind of a person he is?
8. I know that he is a bad person. He has been in prison several times.
9. What was he in prison for?
10. For fighting; for quarreling, he likes to quarrel with people; for carrying a gun without a permit; for disturbing the peace.
11. Are you sure that you are not inventing these things?
12. Why, do you doubt my word? Look at his police record. You yourself have arrested him.
13. Don't get excited and answer my questions! Where were you when the shooting occurred?
14. Behind the gate; I was eavesdropping when they were arguing.
15. What were they arguing about?
16. The victim was asking the killer to pay his debts; that's what they were arguing about.
17. This is not a good enough reason for killing someone.
18. I told you that they were arguing and that the defendant has always been an evil person.

LESSON 62

19. What did you do when he shot the victim?
20. I opened the gate, went out and I saw ....
21. All right. That's enough. Tell the rest to the judge in court when you are called as a witness.  
Sign here!
22. May I read it first?
23. O.K., but make it snappy!

DECLENSION OF PERSONAL PRONOUNS

The following declensions are of personal pronouns:

FIRST PERSON

	Singular	Plural
N.	unë	na
G.	i, e, të mue	i, e, të në
D.	mue, më	në, na
Ac.	mue, më	në, na
Ab.	prej meje	prej nesh

SECOND PERSON

N.	ti	ju
G.	i, e, të ty	i, e, të ju
D.	ty, të	ju, ju
Ac.	ty, të	ju, ju
Ab.	prej teje	prej jush

THIRD PERSON  
(Masculine)

N.	ai	ata
G.	i, e, t'atij	i, e, t'atyne
D.	atij, i	atyne, u
Ac.	atë, e	ata, i
Ab.	prej atij (tij)	prej atyne

THIRD PERSON  
(Feminine)

N.	ajo	ato
G.	i, e, t'asaj	i, e, t'atyne
D.	asaj, i	atyne, u
Ac.	atë, e	ato, i
Ab.	prej asaj (saj)	prej atyne

## Remarks:

The genitive of the first and second person is used very rarely and only when followed by an adjective used as a noun. Examples:

Ky pra është fati i mue të mjerit!  
(This is my bad luck!)  
(Lit. trans. This is the fate of poor me.)

Ky ka qenë gjithëmonë mendimi i në të vjetërvet.  
(This has always been our opinion.)  
(Lit. trans. This has always been the opinion of us grown-ups.)

## RELATIVE PRONOUNS

There are two relative pronouns in Albanian: që and i cili (m.), e cila (f.) - (plural të cilët, të cilat). They refer to a noun or a pronoun and at the same time serve as a connective in a sentence.

a. The relative pronoun i cili, e cila has a complete declension; it may or may not agree with the case of the noun or pronoun it refers to. Examples:

Ky djalë i vogël, të cilit i ap shpesh sheqerna, është shumë i mençëm.  
(This boy, to whom I often give candies, is very smart.)

Prindët e mij, prej të cilëve ka dy muej që s'kam marrë letër, jetojnë n'Evropë.  
(My parents, from whom I haven't heard the last two months, live in Europe.)

The following is the complete declension:

		<u>Masculine</u>	
		Singular	Plural
N.		i cili	të cilët
G.	i, e, të	të cilit	i, e, të të cilëve
D.		të cilit	të cilëve
Ac.		të cilin	të cilët
Ab.	prej	të cilit	prej të cilëve

Feminine

	Singular		Plural
N.	e cila		të cilat
G.	i, e, të së cilës	i, e, të	të cilave
D.	së cilës		të cilave
Ac.	të cilën		të cilat
Ab.	prej së cilës	prej	së cilave

b. The relative pronoun që refers to a noun in the masculine or feminine, singular or plural, but it does not have endings of its own, and also it cannot be preceded by a preposition.

The relative pronoun që is used in the nominative and accusative (objective) cases only; in other words, in kush and kë cases.

1.

- a. Djali, i cili erdhi mbrëmë nga Korça, është rrobagepës.

A është rrobagepës djali, i cili erdhi mbrëmë nga Korça?

Cili djalë është rrobagepës?

Kush është rrobagepës?

Çka është djali, i cili erdhi mbrëmë nga Korça?

Automobili i atij djali, i të cilit është ky libër, është i rfi.

A është i rfi automobili i atij djali, i të cilit është ky libër?

Cili automobil është i rfi?

Automobili i cilit djalë është i rfi?

Automobili i kujt është i rfi?

Nxânsit, të cilit i thash me ardhë nesër, i dhash një fjaluer.

A i dhash një fjaluer nxânsit, të cilit i thash me ardhë nesër?

Cilit nxânes i dhash një fjaluer?

Çka i dhash nxânsit, të cilit i thash me ardhë nesër?

Kujt i dhash një fjaluer?

Librin, të cilin e bleva dje, e kam mbi tryezë.

A e kam mbi tryezë librin, të cilin e bleva dje?

Kush e ka mbi tryezë librin, të cilin e bleu dje?

Cilin libër kam mbi tryezë?

Ku e kam librin, të cilin e bleva dje?

Çka kam mbi tryezë?

Shoku, prej të cilit mora letër, jeton në Francë.

A jeton në Francë shoku, prej të cilit mora letër?

Cili shok jeton në Francë?

Ku jeton shoku, prej të cilit mora letër?

Kush jeton në Francë?

b. Vajza, e cila banon në Rr. Skënderbeg, është nëpunëse.

A është nëpunëse vajza, e cila banon në Rr. Skënderbeg?

Cila vajzë është nëpunëse?

Ç'punë bën vajza, e cila banon në Rr. Skënderbeg?

Kush është nëpunëse?

Çka është vajza, e cila banon në Rr. Skënderbeg?

Çanta e asaj vajze, të së cilës janë këta libra, është përdhë.

A është përdhë çanta e asaj vajze të së cilës janë këta libra?

Çanta e cilës vajzë është përdhë?

Ku është çanta e asaj vajze, të së cilës janë këta libra?

Çanta e kujt është përdhë?

Mësuesja, së cilës i dhash librin, është shqiptare.

A është shqiptare mësuesja, së cilës i dhash librin?

Cila mësuese është shqiptare?

Ç'kombësije është mësuesja, së cilës i dhash librin?

Pëndën, të cilën e harrova mbi tryezë, nuk e gjeta më.

A e gjeta më pëndën, të cilën e harrova mbi tryezë?

Cilën pëndë nuk e gjeta më?

Çka nuk gjeta më?

Vajzës, prej së cilës mora letër, do t'i shkruiej sonte.

A do t'i shkruiej sonte vajzës prej së cilës mora letër?

Cilës vajzë do t'i shkruiej sonte?

Kujt do t'i shkruiej sonte?

Kur do t'i shkruiej vajzës prej së cilës mora letër?

Çka do të bëj sonte?

c. Vllaznit e mij, të cilët jetojnë në Berat, janë nxânës.

A janë nxânës vllaznit e mij, të cilët jetojnë në Berat?

Cilët vllazën janë nxânës?

Çka janë vllaznit e mij, të cilët jetojnë në Berat?

Vllaznit e kujt janë nxânës?

Shokët, të të cilëve janë këta libra, janë jashtë n'oborr.

A janë jashtë n'oborr shokët, të të cilëve janë këta libra?

Cilët shokë janë jashtë n'oborr?

Ku janë shokët, të të cilëve janë këta libra?

Vllazënvët, të cilëve nuk u kam shkruë për një kohë të gjatë, u bëna telefon.

A u bëna telefon vllazënvët, të cilëve nuk u kam shkruë për një kohë të gjatë?

Cilëve vllazën u bëna telefon?

Çka u bëna vllazënvët, të cilëve nuk u kam shkruë për një kohë të gjatë?

Kujve u bëna telefon?

Shokët, me të cilët shkova dje në plazhë, do të nisen nesër.

A do të nisen nesër shokët me të cilët shkova dje në plazhë?

Cilët shokë do të nisen nesër?

Çka do të bëjnë nesër shokët, me të cilët shkova dje në plazhë?

Kur do të nisen shokët, me të cilët shkova dje në plazhë?

Shokët, prej të cilëve marr letra shpesh, janë studenta.

A janë studenta shokët, prej të cilëve marr letra shpesh?

Cilët shokë janë studenta?

Çka janë shokët, prej të cilëve marr letra shpesh?

- d. Motrat e mija, të cilat janë të martueme, jetojnë në Durrës.

A jetojnë në Durrës motrat e mija, të cilat janë të martueme?

Cilat motra jetojnë në Durrës?

Motrat e kujt jetojnë në Durrës?

Ku jetojnë motrat e mija, të cilat janë të martueme?

Dy motrat e tija, e së cilave është kjo ndërtesë, banojnë jashtë qytetit.

A banojnë jashtë qytetit dy motrat e tija, e së cilave është kjo ndërtesë?

Dy motrat e kujt banojnë jashtë qytetit?

Ku banojnë dy motrat e tija, e së cilave është kjo ndërtesë?

Cilat motra banojnë jashtë qytetit?

Nxânsevet të reja, të cilave u dhanë rradhorët, nuk do t'u apin libra.

A do t'u apin libra nxânsevet të reja, të cilave u dhanë rradhorët?

Cilave nxânse nuk do t'u apin libra?

Çka nuk do t'u apin nxânsevet të reja, të cilave u dhanë rradhorët?

Kujve nuk do t'u apin libra?

Nëpunëset e reja, të cilat nuk i njof, filluen sot nga puna.

A filluen sot nga puna, nëpunëset e reja, të cilat nuk i njof?

Cilat nëpunëse filluen sot nga puna?

Çka filluen sot nëpunëset e reja, të cilat nuk i njof?

Kur filluen nga puna nëpunëset e reja, të cilat nuk i njof?

Motrat e Tahirit, prej së cilave merr letra shpesh, jetojnë në Brazil.

A jetojnë në Brazil motrat e Tahirit, prej së cilave merr letra shpesh?

Motrat e kujt jetojnë në Brazil?

Ku jetojnë motrat e Tahirit, prej së cilave merr letra shpesh?

2. A është ulë Zotni .... pranë jush?  
Po, Zotni .... është ulë pranë meje.

Kush është ulë pranë jush?  
Zotni .... është ulë pranë meje.

Pranë kujt është ulë Zotni ....?  
Zotni .... është ulë pranë meje.

Ku është ulë Zotni ....?  
Zotni .... është ulë pranë meje.

A marrin ata leter shpesh prej nesh?  
Po, ata marrin letër shpesh prej nesh.

Cilët marrin letër shpesh prej nesh?  
Ata marrin shpesh letër prej nesh.

Çka marrin ata shpesh prej nesh?  
Ata marrin letër shpesh prej nesh.

Kur marrin ata letër prej nesh?  
Ata marrin letër shpesh prej nesh.

Prej kujt marrin ata letër shpesh?  
Ata marrin letër shpesh prej nesh.

A banon xhaja im afër meje?  
Po, xhaja yt banon afër teje.

Kush banon afër meje?  
Xhaja yt banon afër teje.

Ku banon xhaja im?  
Xhaja yt banon afër teje.

LESSON 62

Afër kujt banon xhaja im?  
Xhaja yt banon afër teje.

Xhaja i kujt banon afër meje?  
Xhaja yt banon afër teje.

A jeton baba yt larg prej teje?  
Po, baba im jeton larg prej meje.

Kush jeton larg prej teje?  
Baba im jeton larg prej meje.

Ku jeton baba yt?  
Baba im jeton larg prej meje.

Baba i kujt jeton larg prej teje?  
Baba im jeton larg prej meje.

Larg prej kujt jeton baba yt?  
Baba im jeton larg prej meje.

A bân me e mbyllë dritoren?  
A bân me shkue në kafe?

A bân me folë pak mâ ngadalë?  
A bân me ecë pak mâ shpejt?

Më thuej mue në qoftë se bân:

Me shkruë në dërrasë të zezë!  
Me e ndezë dritën!  
Me ardhë në klasë pak mâ heret!  
Me hapë dritoren!  
Me më dhënë një laps!  
Me më thënë kush të shkroi!

3. A është mâ i madh Klubi i Oficeravet apor Klubi i Nënoficeravet?  
Klubi i Oficeravet është mâ i madh se Klubi i Nënoficeravet.

Cili klub është mâ i madh, ai i oficeravet apor ai i nënoficeravet?  
Klubi i Oficeravet është mâ i madh se Klubi i Nënoficeravet.

Qysh është Klubi i Oficeravet?  
 Klubi i Oficeravet është më i madh se Klubi i  
 Nënoficeravet.

A e nënshkrueni çekun para se t'a thyeni?  
 Po, unë e nënshkruaj çekun para se t'a thyej.

Kur e nënshkrueni çekun?  
 Unë e nënshkruaj çekun para se t'a thyej.

Çka nënshkrueni para se t'a thyeni?  
 Unë nënshkruaj çekun para se t'a thyej.

Çka bëni para se t'a thyeni çekun?  
 Unë e nënshkruaj çekun para se t'a thyej.

A dyshon Aliu se do të bjerë shi nesër?  
 Po, Aliu dyshon se nesër do të bjerë shi.

Kush dyshon se nesër do të bjerë shi?  
 Aliu dyshon se nesër do të bjerë shi.

Çka dyshon Aliu?  
 Aliu dyshon se nesër do të bjerë shi.

Kur dyshon Aliu se do të bjerë shi?  
 Aliu dyshon se nesër do të bjerë shi.

A keni qenë ndonjiherë dëshmitar në gjyq?  
 Po, unë kam qenë një herë dëshmitar në gjyq.

Kush ka qenë një herë dëshmitar në gjyq?  
 Unë kam qenë një herë dëshmitar në gjyq.

Ku keni qenë një herë dëshmitar?  
 Unë kam qenë një herë dëshmitar në gjyq.

Çka keni qenë një herë?  
 Unë kam qenë një herë dëshmitar në gjyq.

Sa herë keni qenë dëshmitar në gjyq?  
 Unë kam qenë një herë dëshmitar në gjyq.

A keni miqësi me të bijën e Zotni Bajramit?  
 Po, kam miqësi me të bijën e Zotni Bajramit.

Kush ka miqësi me të bijën e Zotni Bajramit?  
Unë kam miqësi me të bijën e Zotni Bajramit.

Me kë keni miqësi?  
Unë kam miqësi me të bijën e Zotni Bajramit.

Çka keni me të bijën e Zotni Bajramit?  
Unë kam miqësi me të bijën e Zotni Bajramit.

Me të bijën e kujt keni miqësi?  
Unë kam miqësi me të bijën e Zotni Bajramit.

A ziheshi shpesh me shokë kur ishi fëmijë?  
Po, kur ishem fëmijë ziheshem shpesh me shokë.

Kush zihesh shpesh me shokë kur ishte fëmijë?  
Unë ziheshem shpesh me shokë kur ishem fëmijë.

Kur ziheshi shpesh me shokë?  
Unë ziheshem shpesh me shokë kur ishem fëmijë.

Çka bájshi shpesh kur ishi fëmijë?  
Unë ziheshem shpesh me shokë kur ishem fëmijë.

Me kë ziheshi shpesh kur ishi fëmijë?  
Unë ziheshem shpesh me shokë kur ishem fëmijë.

A u-vranë shumë njerëz gjatë luftës së dytë  
botënore?  
Po, gjatë luftës së dytë botënore u-vranë shumë  
njerëz.

Kur u-vranë shumë njerëz?  
Gjatë luftës së dytë botënore u-vranë shumë  
njerëz.

Sa njerëz u-vranë gjatë luftës së dytë botënore?  
Gjatë luftës së dytë botënore u-vranë shumë  
njerëz.

Gjatë cilës luftë u-vranë shumë njerëz?  
Gjatë luftës së dytë botënore u-vranë shumë  
njerëz.

LESSON 62

A mund të vriteni po të bini nga karriga?  
Po, po të bij nga karriga mund të vritem.

Kush mund të vritet po të bjerë nga karriga?  
Unë mund të vritem po të bij nga karriga.

Po të bini prej nga mund të vriteni?  
Po të bij nga karriga mund të vritem.

Çka mund të ngjajë po të bini nga karriga?  
Po të bij nga karriga mund të vritem.

A ka shumë borxhe vllai i tij?  
Po, vllai i tij ka shumë borxhe.

Kush ka shumë borxhe?  
Vllai i tij ka shumë borxhe.

Sa borxhe ka vllai i tij?  
Vllai i tij ka shumë borxhe.

Çka ka vllai i tij?  
Vllai i tij ka shumë borxhe.

A e mbyllni portën me çelës kur dilni nga  
shtëpia?  
Po, kur dal nga shtëpia e mbyll portën me çelës.

Kush e mbyll portën me çelës kur del nga shtëpia?  
Unë e mbyll portën me çelës kur dal nga shtëpia.

Çka mbyllni me çelës kur dilni nga shtëpia?  
Unë e mbyll portën me çelës kur dal nga shtëpia.

Me çka e mbyllni portën kur dilni nga shtëpia?  
Unë e mbyll portën me çelës kur dal nga shtëpia.

Kur e mbyllni portën me çelës?  
Unë e mbyll portën me çelës kur dal nga shtëpia.

A është njeri i lig ai njeri që shpif?  
Po, ai njeri që shpif është njeri i lig.

Kush është njeri i lig?  
Ai njeri që shpif është njeri i lig.

LESSON 62

Çfarë njeriu është ai njeri që shpif?  
Ai njeri që shpif është njeri i lig.

Cili njeri është i lig?  
Ai njeri që shpif është njeri i lig.

A është revolveri një armë?  
Po, revolveri është një armë.

Çka është revolveri?  
Revolveri është një armë.

A e kanë zakon grat të rrëfejnë moshën?  
Jo, grat nuk e kanë zakon të rrëfejnë moshën.

Kush nuk e ka zakon të rrëfejë moshën?  
Grat nuk e kanë zakon të rrëfejnë moshën.

Çka nuk kanë zakon grat të bëjnë?  
Grat nuk e kanë zakon të rrëfejnë moshën.

A është ai i ngarkuem të rrejë at ndërtesë?  
Po, ai është i ngarkuem të rrejë at ndërtesë.

Kush është i ngarkuem të rrejë at ndërtesë?  
Ai është i ngarkuem të rrejë at ndërtesë.

Cilën ndërtesë është i ngarkuem ai të rrejë?  
Ai është i ngarkuem të rrejë at ndërtesë.

Çka është ai i ngarkuem të bëjë?  
Ai është i ngarkuem të rrejë at ndërtesë.

Mbrâmë, aty nga ora 6, ndodhi një vrasje. Abaz Golemi, që qe i vetmi dëshmitar në at ngjarje, i bëri këtë tregim policit të ngarkuem me mbajtje proces-verbalin:

Dje në orën 5 të mbrastresës merrja në shtëpi nga puna. Hypa në dhomën time, veshja një palë rrobe të vjetra dhe mandej zbrita poshtë për të punuar në kopsht: këto ditë jam tue mbjellë ca zarzavate. Kur po ujtitshem sallatën, më duk sikur dy vetë po flitshin me zë në naltë në rrugë, tamam para portës. Zhurma e ujit nuk më linte me kuptue çka po thojshin. Ndala ujin dhe fillova me përgjue: po ziheshin për një borxh të vjetër. "I due paret tash, nxiri!" i thonte njëri. "Nuk due me t'i dhënë" i përgjegjte tjetri dhe përdorte fjalë të këqija kundër tij. Edhe i pari filloi të shante. Fjalët e ndyta duket se e zemruen shumë njërin sepse shtiu tri herë me revolver. Dola jashtë dhe çka me pa! Njëri ishte shtrif përdhë dhe nga goja po i dilte gjak; tjetri, me revolver në dorë, po u-largonte tue ecë ngadalë. E njofta se kush ishte vrasësi. E kishem pa shpeshherë në klubin e punëtorëve, ku ai vinte me luejtë kartash ase

bilardo. Çdo herë që luate zihesh me ndokënd. Të gjithë thonë se është njeri i lig, se ka qenë në burg herë për një arsye e herë për një tjetër: për prishjen e qetësisë publike, për mbajtje arme pa leje, për zihje etj.

Vrasësi s'ishte largue as 50 metra kur mrrijtën ca policë dhe menjherë e arrestuen; i u-afruen të vramit dhe mbasi panë se kishte vdekë, e mbuluen me një çarçaf që u dhash unë. Ndërkaq, në vendin e ngjarjes erdhën edhe ca policë tjerë e civila, ndoshta të Sigurimit. Njëni prej tyre më mori emnin e mbiemnin e adresën dhe më tha që të vij këtu, në zyrat e policisë, që të më marri në pyetje. Kaq dij.

Nënshkruen: ABAZ GOLEMI

## QUESTIONS-PYETJE

1. Ç'ndodhi mbrâmë aty nga ora 6?
2. Kush qe i vetmi dëshmitâr n'at ngjarje?
3. Kujt i a bâni kët tregim Abaz Golemi?
4. Në ç'orë mrrîjti ai në shtëpi nga puna?
5. Kush mrrîjti në shtëpi nga puna dje n'orën 5 të mbasdrekes?
6. Ku shkoi dhe çfarë rrobesh veshi?
7. Ku zbriti mandej?
8. Pse zbriti poshtë?
9. Çka âsht tue mbjellë këto ditë në kopsht?
10. Kush âsht tue mbjellë ca zarzavate në kopsht?
11. Kur ndigjoi dy vetë tue folë me zâ të naltë në rrugë para portës?
12. Kush ndigjoi dy vetë tue folë me zâ të naltë në rrugë para portës së tij?
13. Ku po flitshin dy vetë me zâ të naltë?
14. Çka nuk e lënte me kuptue se çka po thojshin?
15. Çfarë zhurme nuk e lënte me kuptue se ç'po thojshin?
16. Ç'bâni ai mandej?
17. Kush e ndali ujin dhe filloi të përgjonte?
18. Për çka po ziheshin?
19. Ç'thonte njâni?
20. Ç'përgjegjte tjetri dhe çfarë fjalësh përdorte kundër të parit?

LESSON 62

21. Ç'filloi të bânte i pari?
22. Kê zemruen fjalët e ndyta të të parit?
23. Ç'ngjau mandej?
24. Sa herë shtiu me revolver njëni prej tyne?
25. Ç'pá kur doli jashtë?
26. Si e gjeti njënin prej tyne dhe ç'po i dilte nga goja?
27. Po tjetri, ç'kishte në dorë dhe ç'po bânte?
28. Kush e njofti se cili ishte vrasësi?
29. Ku e kishte takue Abaz Golemi shpeshherë vrasësin?
30. Ç'vînte me luejtë vrasësi në klubin e punëtorëvet?
31. Me kê zîhesh i pandehuni çdo herë që vînte në klub?
32. Kush thotë se ai âsht njeri i lig e se ka qenë në burg për fajë të ndryshme?
33. Për ç'fajë ka qenë në burg shumë herë i pandehuni?
34. Kur mrrîjtën ca policë në vendin e ngjarjes?
35. Kush e arrestoi të pandehunin?
36. Me çka e mbuluen njerin kur e panë se kishte vdekë?
37. Kush u a dha atyne çarçafin, me të cilin mbuluen të vramin?
38. Kush tjetër, përveç policëvet, erdhi në vendin e ngjarjes?

LESSON 62

39. Kush i a mori emnin dhe mbiemnin Abaz Golemit?
40. Ku i tha me shkue Abaz Golemit njëni prej policëve-  
vet dhe pse i tha me shkue atje?



Qendra e qytetit alpin  
-Bajram Curri-

PJESA E GJASHTË  
DETYRË SHTEPIJE

LESSON 62  
PART VI  
HOMEWORK

A. Përkëtheni anglisht:

1. Nuk më mjaftojnë paret që kam për të pague të gjitha borxhet.
2. Rash nga shkalla dhe u-vrava shumë.
3. Detyra e policisë është për të mbajtur qetësinë publike.
4. U-zënë kot dhe gati u-vranë.
5. Gjithëmonë kam dyshue se ai ka faj në këto punë.

B. Translate the following sentences:

6. It's forbidden to play cards in this club, (either) with or without money.
7. He interrogated me and I told him what I know.
8. Do you have any insurance on your house?
9. His file is not here; it's at the Ministry of the Interior.
10. I signed the check and gave it to him.

PJESA E SHTATË  
FJALORI

LESSON 62  
PART VII  
VOCABULARY

armë, -a armë, -t	(f.)	weapon, branch (mil.)
me arrestue (unë arrestoj)	(v.)	to arrest
borxh, -i borxhe, -t	(m.)	debt
dëshmitár, -i dëshmitarë, -t	(m.)	witness
dosje, -a dosje, -t	(f.)	dossier, file
me dyshue (unë dyshoj)	(v.)	to doubt, to suspect
grindje, -a grindje, -t	(f.)	quarrel, brawl, argument
gjyq, -i gjyqe, -t	(m.)	court; trial, case (lawsuit)
kartë, -a karta, -t	(f.)	card, paper
klub, -i klube, -t	(m.)	club
i lig, të ligj e ligë, të liga	(adj. m.&f.)	bad, wicked; coward; sick
mbajtje, -a	(f.)	carrying or bearing (weapons); keeping, holding, withhold- ing, support
miqësi, -ja miqësi, -t	(f.)	friendship

LESSON 62

me mjaftue (unë mjaftoj)	(v.)	to be enough, to be sufficient, to suffice
me nënshkrue (unë nënshkruej)	(v.)	to sign, to under- sign
i, të ngarkuem e, të ngarkueme	(adj. m.&f.)	in charge; loaded
ngjarje, -a ngjarje, -t	(f.)	incident, event, happening, occurrence
i pandehun, -i të pandehun, -it	(m.)	defendant
me përgjue (unë përgjoj)	(v.)	to eavesdrop
polic, -i policë, -t	(m.)	policeman
policf, -ja	(f.)	police department, police
portë, -a porta, -t	(f.)	gate, door, goal
prishje, -a prishje, -t	(f.)	break, breaking, spoiling, ruin, damage, demolition, destruction; wear
proces-verbal, -i proces-verbale, -t	(m.)	a statement made by the defendant and- or a witness
publik, -e	(adj. m.&f.)	public
qetësi, -ja	(f.)	quietness, calmness, tranquillity, peace (public order)
revolver, -i revolvera, -t	(m.)	revolver

LESSON 62

rreth	(pref. & adv.)	about, around
me rrëfye (unë rrëfej)	(v.)	to tell, to show, to confess
sigurim, -i sigurime, -t	(m.)	security, insurance
me shpifë (unë shpif)	(v.)	to slander, to calumniate, to libel
i vrami të vramët	(m.)	dead (killed by shooting)
vrasës, -i vrasës, -it	(m.)	killer, murderer
vrasje, -a vrasje, -t	(f.)	murder, killing (by shooting)
me u-zânë (unë zihem)	(v.)	to argue, to fight, to quarrel
zihje, -a	(f.)	quarrel, argument, brawl

Shenime:

me marrë në pyetje (unë marr në pyetje)	to interrogate
me mbajtë procesverbal (unë mbaj procesverbal)	to write an interrogatory statement
.... për prishjen e qetësis publike	.... for disturbing the peace
kur po ziheshin me fjalë	when they were arguing
A bân t'a lexoj më parë?	May I first read it?